

# LIGJ PËR CILËSINË E AJRIT TË AMBIENTIT

TEKST I KONSOLIDUAR <sup>1</sup>

**Teksti në  
gjuhën  
Maqedonase**  
Закон за  
квалитетот на  
амбиентниот воздух

## I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

#### Lënda e rregullimit

Me këtë ligj rregullohen masat për evitimin, parandalimin ose zvogëlimin e efekteve të dëmshme nga ndotja e ajrit të ambientit ndaj shëndetit të njeriut, si dhe mjedisit jetësor si tërësi, përmes caktimit të vlerave kufizuese për cilësinë e të ambientit ajrit të ambientit dhe shkallët e alarmimit, dhe prag i informimit, vlerat kufitare dhe qëllimore për emision, formimi i sistemit unik për përcjelljen dhe kontrollin e cilësisë së ajrit të ambientit dhe përcjelljen e burimeve të emisioneve, sistemin gjithëpërfshirës për menaxhim me cilësinë e ajrit të ambientit dhe burimin e emisioneve, sistemin informativ si dhe masave të tjera për mbrojtje nga aktivitetet e caktuara të personave fizikë dhe juridikë të cilët kanë ndikim direkt ose indirekt ndaj cilësisë së ajrit.

### Neni 2

#### Zbatimi i ligjit

Dispozitat e këtij ligji kanë të bëjnë me ajrin e ambientit përveç ndotjes së ajrit të ambientit të shkaktuar nga substancat radioaktive, zhurmës dhe fatkeqësive elementare dhe ndotjes së ajrit në mjedisin e punës.

### Neni 3

#### Qëllimet e ligjit

Qëllimet e këtij ligji janë:

- evitimi, parandalimi dhe zvogëlimi i efekteve të dëmshme ndaj shëndetit të njeriut dhe ambientit jetësor si tërësi, duke i përfshirë edhe lloj-llojshmërinë biologjike, pasurinë natyrore dhe trashëgiminë historike e kulturore;
- sigurimi i informatave përkatëse për kualitetin e ajrit të ambientit;
- parandalimi dhe zvogëlimi i ndotjeve që shkaktojnë ndryshimin e klimës, dhe
- mirëmbajtja e kualitetit të ajrit të ambientit aty ku është i mirë dhe përmirësimi në raste të tjera.

### Neni 4

#### Përkufizime

Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë këtë domethënie:

- 1) **"ajër i ambientit"** është ajri i jashtëm në pjesën e poshtme të

troposferës, me përjashtim të ajrit në mjedisin e punës;

- 2) **"kualiteti i ajrit të ambientit"** - është gjendja e ajrit të ambientit e paraqitur përmes shkallës së ndotjes;
- 3) **"ndotja e ajrit"** - është ndryshimi i kualitetit të ajrit të ambientit si rezultat i veprimeve të njerëzve me futjen e drejtpërdrejtë dhe në mënyrë të tërthortë të substancave ndotëse të cilat mund të jenë të dëmshme ndaj shëndetit të njeriut dhe ambientit jetësor, ose të shkaktojnë dëm në pronën materiale, e prishin ose ndikojnë ndaj bukurive natyrore dhe mënyrave të tjera legjitime të shfrytëzimit të ambientit jetësor;
- 4) **"substancë ndotëse e ajrit"** - është çdo substancë të cilën njeriu drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë e fut në ajrin e ambientit, dhe për të cilën ekziston mundësia se do të ketë efekte të dëmshme ndaj shëndetit të njeriut, gjegjësisht ndaj mjedisit jetësor si tërësi;
- 5) **"niveli"** - është koncentrimi i ndonjë substance ndotëse në ajrin e ambientit ose shtresimit të saj mbi sipërfaqen për një periudhë të caktuar kohore;
- 6) **"vlera kufitare"** - është niveli i caktuar në bazë të njohurive shkencore, me qëllim të evitimit, parandalimit ose zvogëlimit të efekteve të dëmshme ndaj shëndetit të njerëzve gjegjësisht mjedisit jetësor si tërësi, dhe e cila duhet të arrihet në periudhë të dhënë dhe nëse njëherë arrihet më të mos tejkalohet;
- 7) **"vlerësimi"** - është çdo metodë e cila shfrytëzohet për matje, llogaritje, parashikim ose për vlerësim të nivelit të ndonjë substance të dëmshme në ajrin e ambientit;
- 8) **"teknikat për modelim"** - shënon qasje të lloj-llojshme matematikore për prezantimin e proceseve fizike dhe kimike në ajrin e ambientit si dhe procedurat për ndryshim të këtyre formulimeve, së bashku me të dhënat e kërkuara hyrëse për t'u zbatuar modelimi i kualitetit të ajrit të ambientit;
- 9) **"shkalla e lartë e vlerësimit"** - është niveli ku mund të shfrytëzohet kombinimi i masave dhe teknikave për modelim që të vlerësohet kualiteti i ajrit të ambientit;
- 10) **"shkalla e ulët e vlerësimit"** - është niveli ku mund të shfrytëzohen vetëm teknikat për modelim ose për vlerësim objektiv të kualitetit të ajrit të ambientit;
- 11) **"Vlera qëllimore e ajrit të ambientit"** - është niveli i përcaktuar me qëllim të evitimit të efekteve të dëmshme afatgjate ndaj shëndetit të njeriut gjegjësisht ambientit jetësorë si tërësi, e që duhet të arrihet atëherë kur është e mundur gjatë afatit të caktuar kohorë;
- 12) **"pragu i alarmimit dhe prag i informimit"** - është niveli i ndotjes prej kur fillon të ekzistojë rreziku ndaj shëndetit të njeriut, si rezultat i ekspozimit të shkurtë, gjegjësisht niveli prej kur fillojnë të ndërmerren masa të drejtpërdrejta të definuara me këtë ligj;
- 13) **"margjina të tolerancës për vlerë kufitare"** - është përqindja e vlerës kufitare me të cilën kjo vlerë mund të tejkalohet në kushte të definuara në pajtim me këtë ligj;
- 14) **"emisioni"** - është lëshimi i substancave të ndotura në ambientin ajrit;
- 15) **"vlera kufitare e emisionit"** - është sasi e lejuar e substancës ndotëse e përfshirë në gazrat e ndotura të emituara në periudhë të caktuar, që nuk duhet të tejkalohet;
- 16) **"gazrat e ndotura"** - janë gazra të lëshuara në ajrin e ambientit që përmbajnë sasi të gazrave të forta, të lëngshme ose emisione gazrash. Të dhënat volumetrike shprehen në metër kub në orë në temperaturë

standarde prej 273 shkallësh kelvini dhe presion prej 101,3 kilopaskalësh.

17) **"burimi i emisionit"** - është vendi ose sipërfaqja prej së cilës lëshohen substanca ndotëse në ambientin ajrit;

18) **"transmisioni"** - janë efekte të kombinuara nga transporti dhe reaksioni atmosferik ndaj substancave ndotëse;

19) **"kadastrri i ndotësve në ajër"** është evidenca kualitative dhe kuantitative e substancave ndotëse dhe burimeve të ndotjes që lëshojnë substanca ndotëse në ajër ku është përfshirë edhe harta e ndotësve;

20) **"zona"** - është pjesë e territorit të Republikës së Maqedonisë me kufij të definuar për qëllimet e vlerësimit dhe administrimit me kualitetin e ajrit të ambientit;

21) **"aglomeracioni"** - është zona në të cilën dendësia e popullsisë është mbi 250. 000 banorë, ose aty ku dendësia e popullatës është më pak se 250.000 banorë, por ku dendësia e popullatës në km<sup>2</sup> e arsyeton nevojën e vlerësimit të kualitetit të ajrit të ambientit dhe menaxhimin me të;

22) **"monitorimi i kualitetit të ajrit të ambientit"** - është matje e sistematizuar, e kontinuar, përcjellje dhe kontroll i ndryshimit të gjendjes dhe ndryshimet e kualitetit në ambientin e ajrit;

23) **"vendlëshimi"** është vendi i lëshimit dhe/ose rrjedhja e substancave ndotëse nga ndonjë burim i caktuar i ndotjes në ajrin e ambientit;

24) **"shtresa përdhese"** është ajri në zonën e frymëmarrjes së njeriut;

25) **"lokacioni i fiksuar"** - është vendi ku duhet të maten ndotësit, matjet zbatohen në lokacionet e fiksuara, në mënyrë të kontinuar ose me marrjen e mostrave sipas zgjedhjes së rastit, ndërsa numri i matjeve duhet të jetë i mjaftueshëm për përcaktimin e niveleve të vërejtura.

26) **"avaria"** - është dukuri në formë emisioni të madh, zjarr ose shpërthim si rezultat i ngjarjeve të pakontrolluara gjatë punës në çfarëdo lloj sistemi, me pjesëmarrje të një apo më shumë substancave të dëmshme dhe të rrezikshme, e që sjellin rrezik serioz për shëndetin e njerëzve dhe për ambientin jetësor, menjëherë ose më vonë, në sistem ose jashtë tij si rezultat i asaj që lirohen një ose më shumë substanca të rrezikshme në ajrin e ambientit.

27) **"instalimi"** - është njësi teknike e palëvizshme ku kryhen një ose më shumë veprime në bazë të aktivitetit industrial që është lëndë e vlerësimit të ndikimeve mbi ambientin jetësor dhe të gjitha veprimeve të tjera të lidhura drejtpërsëdrejti me to ose janë të lidhura në mënyrë teknike me veprime që zbatohen në atë lokacion, dhe të cilat do kishin mundur të kenë efekt ndaj emisioneve të gazrave të ndotura dhe ndotësve.

28) **"organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në sferën e ambientit jetësor"** - është organ i themeluar me Ligjin për ambientin jetësor.

29) **"Prag i informimit"** është niveli i përqendrimit të substancës ndotëse në ajrin e ambientit mbi të cilën ekziston rrezik për shëndetin e njeriut gjatë ekspozimit afatshkurtër, veçanërisht pjesëve të ndjeshme nga popullata, gjegjësisht nivelit me ç'rast është nevojshëm informimi në kohë.

30) **"Dukuri natyrore"** në kuptim të këtij ligji, janë erupsione vullkanike, aktivitete sizmike, aktivitete gjeotermike, zjarre nën qiell të hapur, paraqitje të erërave të larta ose risuspenzim atmosferik ose bartje e grimcave të suspenduara nga rajonet e thata.

31) **"Vende matëse"** janë vende në territorin e Republikës së Maqedonisë, ku edhe bëhen matje të veçanta të kualitetit të ajrit të ambientit në rajone për të cilat ekzistojnë indikacione se ka përqendrim

të zmadhuara të substancave ndotëse ose të dhënat nga matja janë të nevojshme për shkak të sigurimit të masave për planifikim në menaxhimin me kualitetin e ajrit të ambientit.

32) **"Instalim që digjet"** është secili instalim teknik në të cilin oksidohen lëndë djegëse me qëllim që të shfrytëzohet ngrrohtësia që lirohet në atë mënyrë.

33) plane për cilësinë e ajrit, janë planet me të cilat përcaktohen masat për arritje të vlerave kufizuese dhe qëllimore;

34) kontribute nga burimet natyrore, janë emisionet e substancave ndotëse të ajrit, të cilat nuk janë shkaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga aktivitetet e njerëzve, duke i përfshirë edhe dukuritë natyrore, siç janë erupsionet vullkanike, aktivitetet sizmike, aktivitetet gjeotermike, zjarret pyjore, erërat e fuqishme, vërshimet e ujërave ose risuspendimi atmosferik ose bartja e grimcave natyrore nga rajonet e thata;

35) lokacione në prapavijë në mjedise urbanë, janë vendet në mjedise të qytetit, ku nivelet për ekspozimin e popullatës së përgjithshme urbane janë reprezentative;

36) AOT 40, e paraqet shumën e dallimeve ndërmjet koncentrimëve të ozonit sipërfaqësor të matura çdo orë, më të mëdha se  $80 \mu\text{g}/\text{m}^3$  (=40 ppb) dhe  $80 \mu\text{g}/\text{m}^3$  gjatë orëve të ditës, të grumbulluara nga muaji maj deri në korrik çdo vit;

37) AOT 60, e paraqet shumën e dallimeve ndërmjet koncentrimëve të ozonit sipërfaqësor të matura çdo orë, më të mëdha se  $120 \mu\text{g}/\text{m}^3$  (=60 ppb) dhe  $120 \mu\text{g}/\text{m}^3$  të grumbulluara gjatë vitit;

38) njoftim për emisionet vjetore, është njoftimi për të gjitha emisionet e substancave ndotëse në rajonin e territorit të Republikës së Maqedonisë, i cili përgatitet dhe kryhet në nivel vjetor në formë dhe mënyrë sipas Konventës për ndotje tejkufitare të ajrit, në largësi të mëdha dhe protokolleve të saj dhe vendimeve dhe kaheve, të miratuara në trupin ekzekutiv të konventës;

39) njoftim për politikën dhe masat për zvogëlimin e emisioneve, është njoftimi për politikën dhe masat e Republikës së Maqedonisë, me të cilat kufizohen dhe/ose zvogëlohen emisionet e substancave ndotëse me vlerësime të dhëna kuantitative të ndikimit të politikës dhe masave, të paraqitura në sektorë të veçantë, si dhe të dhëna tjera për dorëzimin e Programit për bashkëpunim për ndjekjen dhe vlerësimin e bartjes me shtrirje të gjerë të substancave ndotëse të ajrit në Evropë (EMER) për çdo substancë ndotëse në veçanti;

40) inventar i emisioneve, është përmbledhja e të dhënave (të shprehura me kilotone në vit) gjatë periudhës së caktuar kohore, sipas kërkesave të dhëna ose metodologjisë së dhënë me shpërndarje adekuate sektoriale, kohore dhe hapësinore, specifike për çdo substancë ndotëse në veçanti;

41) nivel kritik, është koncentrimi i substancave ndotëse në atmosferë mbi të cilin mund të paraqiten efekte të drejtpërdrejta të padëshirueshme të receptorët, siç janë njerëzit, bimët, ekosistemet ose materialet, sipas njohurive të deritanishme;

42) ngarkesë kritike, është vlerësimi kuantitativ i ekspozimit të një ose më shumë substancave ndotëse, të cilat nuk shkaktojnë efekte të padëshirueshme të konsiderueshme, për mjedise konkrete të ndjeshme dhe/ose sfera të mjedisit jetësor sipas njohurive të deritanishme dhe

43) kuadrat, është katrori me dimensione 150 km x 150 km, i cili paraqet rezolucion që shfrytëzohet kur paraqiten ngarkesat kritike të substancave ndotëse në hartën e Republikës së Maqedonisë, ose në nivel evropian, dhe gjithashtu kur bëhet monitorimi i emisioneve dhe shtresimeve të

substancave ndotëse në ajër, sipas Programit për bashkëpunim për përcjelljen dhe vlerësimin e bartjes me shtrirje të gjerë, të substancave ndotëse në ajër në Evropë (EMER).

## II. PARIMET PËR MENAXHIM ME KUALITETIN E AJRIT TË AMBIENTIT DHE BURIMET E EMISIONEVE

### Neni 5

#### Parimi i sjelljes së kujdesshme dhe me përgjegjësi

Gjatë kohës së aktiviteteve që do të kishin mundur të kenë ndikim mbi cilësinë e ajrit të ambientit, çdokush është i obliguar të sillet me kujdes dhe përgjegjësi që të evitohet dhe të parandalohet ndotja e ajrit të ambientit dhe efektet e dëmshme ndaj shëndetit të njeriut dhe ambientit jetësor në tërësi.

### Neni 6

#### Parimi i perspektivës kohore

Afatet kohore në planet, programet dhe vendimet për udhëheqje me kualitetin e ajrit të ambientit duhet të përkojnë me perspektivën kohore të efekteve të pritura.

### Neni 6-a

#### Parim i vigjilencës

Organet kompetente janë të obliguara që t'i ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme me qëllim që të mos bëhet zvogëlimi i vlerave kufitare dhe qëllimore për substanca ndotëse në ajrin e ambientit, në pajtim me nenin 10 të këtij ligji, pa mos krijuar me këtë rast shpenzime të panevojshme

### Neni 7

#### Zbatimi i parimeve të tjera

Krahas parimeve nga neni 5, 6 dhe 6-a të këtij ligji për mbrojtjen e kualitetit të ajrit të ambientit zbatohen edhe parimet e përcaktuara në Ligjin për ambientin jetësor.

## III. BURIMET E NDOTJES

### Neni 8

#### Burimet e ndotjes

(1) Burimet e ndotjes së ajrit të ambientit në pajtim me këtë ligj janë:

- 1) instalime në të cilat zhvillohen procese teknologjike, djegia e hedhurinave, prodhimi i energjisë (në tekstin e mëtejshëm: burime stacionare);
- 2) motorë me djegie të brendshme të instaluar në makina lëvizëse jorrugore, lokomotiva, anije dhe aeroplanë (në tekstin e mëtejshëm: burime lëvizëse jorrugore);
- 3) motorë me djegie të brendshme të instaluar në automjete (në tekstin e mëtejshëm: burime lëvizëse);
- 4) djegia e të gjitha llojeve të lëndëve djegëse dhe
- 5) dukuri natyrore.

(2) Burimet e ndotjes nga paragrafi (1), pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, projektohen, ndërtohen, pajisen, mirëmbahen dhe punojnë në atë mënyrë që të mos lëshojnë substanca ndotëse në ajrin e ambientit në sasi më të madhe nga vlerat e caktuara kufitare për emision.

(3) Burimet e ndotjes nga paragrafi (1) pika 4 e këtij neni, nuk guxojnë të prodhohen, importohen dhe lëshohen në qarkullim përderisa nuk i kënaqin vlerat e caktuara kufitare për përmbajtjen e substancave dëmtuese dhe kërkesat tjera për kualitetin e lëndëve djegëse në pajtim me rregullën nga neni 16 të këtij ligji.

## IV. VLERAT UNIKE KUFITARE DHE QËLLIMORE

### Neni 9

#### Llojet e vlerave kufitare dhe qëllimore dhe nivelet kritike

Për evitimin, parandalimin ose zvogëlimin e efekteve dëmtuese ndaj shëndetit të njeriut dhe ndaj ambientit jetësor si tërësi, caktohen llojet vijuese të vlerave kufitare si dhe niveleve kritike:

- 1) vlerat kufitare, vlerat qëllimore dhe nivelet kritike për kualitetin e ajrit të ambientit dhe pragjet e alarmimit;
- 2) vlerat kufitare për emisione të gazrave të ndotura dhe avujve nga burimet stacionare;
- 3) vlerat kufitare për emisione të gazrave të ndotura të burimeve të lëvizshme;
- 4) përmbajtja e substancave të dëmshme në lëndët djegëse.

### Neni 10

#### Kritere për kualitetin e ajrit të ambientit

(1) Për arritjen e qëllimeve për kualitet të ajrit të ambientit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të organit kompetent të administratës shtetërore për punët nga sfera e ambientit jetësor dhe organit të administratës kompetent shtetërore për punët në sferën e shëndetësisë përcakton:

- 1) vlera kufitare, vlera qëllimore dhe nivele kritike për llojet e substancave ndotëse në ajrin e ambientit (në tekstin e mëtejshëm: vlera kufitare për kualitet) dhe pragje të alarmimit dhe prag të informimit;
- 2) afatet për arritjen e vlerave kufitare për substancat e caktuara ndotëse;
- 3) margjinat e tolerancës për vlerë kufitare; dhe
- 4) vlerën qëllimore dhe qëllimet afatgjate për substanca të caktuara ndotëse.

(2) Varësisht nga niveli dhe karakteri i ndotjes së ajrit të ambientit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë në kuptim të paragrafit (1) pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, mund të përcaktoj vlera më rigorozë kufitare për kualitetin në sfera të caktuara me propozim të këshillit të komunës ose të Këshillit të qytetit të Shkupit.

### Neni 11

#### Faktorët të cilët rekomandohen

Qeveria e Republikës së Maqedonisë gjatë përcaktimit të llojeve të substancave ndotëse mban llogari për faktorët vijues:

- 1) mundësia, serioziteti dhe shpeshtësia e efekteve ndaj shëndetit të njeriut dhe/ose mjedisit jetësor si tërësi me atë që duhet të mbahet llogari e posaçme për efektet e papërmirësueshme;
- 2) prezenca dhe koncentrimi i lartë i ndotjes në atmosferë;
- 3) transformime në mjedisin jetësor ose ndryshime metabolike që mund të sjellin deri në krijimin e kemikaleve me toksicitet më të madh;

4) qëndrueshmëri në mjedisin jetësor, nëse ndotësi nuk është biozbërthyes dhe mund të akumulohet në organizëm të njeriut, në mjedisin jetësor dhe në zinxhirin e ushqimit, dhe

5) ndikimi i ndotësit:

- mbi madhësinë e popullatës së ekspozuar, bioresurset ose ekosistemet,
- ekzistimi i caqeve posaçërisht të ndjeshme në zonën gjegjëse,
- si dhe sipas nevojës zbatimi i metodave për vlerësimin e rrezikut.

## **Neni 12**

### **Shmangia nga vlerat kufitare dhe qëllimore**

(1) Gjatë përcaktimit të vlerës kufitare dhe qëllimore për çdo substancë ndotëse dhe periudhës së nevojshme për zbatimin e masave për përmirësimin e kualitetit të ajrit të ambientit, duke mbajtur llogari për nivelin real të substancës së dhënë ndotëse, Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të organit të administratës shtetërore kompetente për punët në sferën e mjedisit jetësor dhe organit të administratës shtetërore kompetente për punët në sferën e shëndetësisë mund të përcaktojë devijim nga vlerat e përcaktuara kufitare për kualitet.

(2) Devijimet e lejuara nga paragrafi (1) të këtij neni zvogëlohen gradualisht që të arrihet niveli i vlerave kufitare dhe qëllimore për kualitet më së voni në fund të periudhës së caktuar, specifike për çdo substancë ndotëse, në pajtim me afatet e miratuara për arritjen e vlerave kufitare për kualitet. <sup>2</sup>

## **Neni 13**

### **Vlerat kufitare për emision të gazrave të ndotura dhe avujve nga burimet stacionare**

(1) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët në sferën e shëndetësisë i përcakton vlerat kufitare për nivelet e lejuara të emisioneve dhe llojet e substancave ndotëse në gazrat e ndotura dhe avujt, që i emitojnë burimet stacionare në ajër (në tekstin e mëtejshëm: vlerat kufitare për emision), me qëllim që të sigurohet kualiteti i ajrit të ambientit në mënyrë përkatëse me vlerat e caktuara kufitare për kualitet të përcaktuar me dispozitat e nenit 10 të këtij ligji.

## **Neni 14**

### **Vlerat kufitare për emision nga burimet e lëvizshme**

Vlerat kufitare për emision dhe llojet e substancave ndotëse në gazrat e hedhura nga burimet lëvizëse të ndotjes (në tekstin e mëtejshëm: emisione nga burime lëvizëse) janë përcaktuar me rregullat të cilat e rregullojnë veprimin me automjete.

## **Neni 15**

### **Obligimet e përgjithshme**

(1) Vlerat e caktuara kufitare për emision nga neni 13 i këtij ligji janë të obligueshme për të gjitha objektet dhe instalimet që janë në fazë të projektimit, ndërtimit, rekonstruimit dhe eksploatimit pa dallim a janë nga veprimtaria prodhuese ose joprodhuese.

(2) Vlerat e caktuara kufitare për emision nga neni 14 i këtij ligji janë të obligueshme për të gjitha burimet e lëvizshme të ndotjes.

## **Neni 16**

## **Përmbajtja e substancave të dëmshme në lëndët djegëse**

Vlerat kufitare të përmbajtjes dhe llojeve të substancave të dëmshme si dhe kërkesat tjera për kualitetin e lëndëve djegëse i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e ekonomisë në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

## **V. MENAXHIMI ME KUALITETIN E AJRIT TË AMBIENTIT**

### **Neni 17**

#### **Mënyrat e menaxhimit**

Menaxhimi me kualitetin e ajrit të ambientit kryhet përmes:

- 1) vlerësimin të kualitetit të ajrit të ambientit; dhe
- 2) miratimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikuara.

## **1. VLERËSIMI I KUALITETIT TË AJRIT TË AMBIENTIT**

### **Neni 18**

#### **Lënda e vlerësimit**

Vlerësimi i kualitetit të ajrit të ambientit në territorin e Republikës së Maqedonisë për çdo substancë ndotëse në të gjithë zonat dhe aglomeracionet bëhet në bazë të matjeve të rregullta përmes rrjetit shtetëror, si dhe matjet përmes rrjeteve lokale dhe matjet e emisioneve nga burimet stacionare dhe të lëvizshme të ndotjes që kryhen gjatë një viti, me mundësi për shfrytëzimin e teknikave për modelim.

### **Neni 19**

#### **Organet kompetente**

(1) Vlerësimin e kualitetit të ajrit të ambientit e kryen organi i administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësorë.

(2) Vlerësimin e kualitetit të ajrit të ambientit në territorin e Republikës së Maqedonisë në afërsi të kufirit ndërkombëtar, e bën organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor në bashkëpunim me organin kompetent të shtetit fqinj.

(3) Vlerësimin e rrezikut shëndetësor lidhur me kualitetin e ajrit të ambientit e kryen organi i administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e shëndetësisë.

### **Neni 20**

#### **Metodologjia e vlerësimit**

Kriteret, metodat dhe procedurat për vlerësimin e kualitetit të ajrit të ambientit i cakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor dhe ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e shëndetësisë.



## Neni 21

### Vlerësimi preliminar

(1) Me qëllim që të përgatiten dhe vendosen vende matëse për monitorim dhe matje të kualitetit të ajrit të ambientit, duhet të kryhet vlerësimi preliminar i kualitetit të ajrit të ambientit.

(2) Vlerësimi preliminar bazohet në masat ekzistuese dhe/ose masat reprezentative të koncentrimëve të substancave ndotëse së paku për pesë vitet e fundit.

(3) Aty ku nuk janë të arritshme masat ekzistuese ose nuk ka matje duhet të shfrytëzohen masat reprezentative plotësuese me të dhënat nga kadastrin i ndotësve të ajrit modelimi i kualitetit të ajrit të ambientit ose me zbatimin e teknikave për vlerësimin e qëllimeve.

## Neni 22

### Klasifikimi i zonave dhe aglomeracioneve

(1) Në bazë të vlerësimit për kualitetin e ajrit të ambientit në territorin e Republikës së Maqedonisë themelohen zona dhe aglomeracione për kualitetin e ajrit, nga ana e organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Klasifikimi i çdo zone dhe aglomeracioni për çdo substancë ndotëse kryhet në pajtim me nivelet e koncentrimit të substancave ndotëse lidhur me pragjet e sipërme dhe të poshtme të vlerësimit.

(3) Klasifikimi nga paragrafi (2) i këtij neni revidohet së paku në çdo pesë vjet.

(4) Revidimi i klasifikimit të zonave dhe aglomeracioneve nga paragrafi (2) i këtij neni, mund të bëhet edhe me herët në rast të ndryshimeve të konsiderueshme të aktiviteteve relevante, të cilat ndikojnë në koncentrimet e substancave të caktuara ndotëse, në ajrin e ambientit.

## Neni 22-a

Zonat me nivele më të ulëta se vlerat e përcaktuara kufitare dhe qëllimore Në zonat dhe aglomeracionet nga neni 22 i këtij ligji veprohet në mënyrë preventive, me qëllim që të ruhen nivelet e substancave ndotëse nën vlerat e përcaktuara kufitare dhe qëllimore për kualitet dhe insistohet që të ruhet kualiteti më i mirë i ajrit të ambientit në pajtim me principin e zhvillimit të qëndrueshëm.

## 2. PLANIFIKIMI I MBROJTJES SË KUALITETIT TË AJRIT TË AMBIENTIT

## Neni 23

### Dokumentet themelore të planifikuara

Për shkak të realizimit të qëllimeve të parashtruara për kualitet të ajrit të ambientit në pajtim me këtë ligj si dhe për shkak të planifikimit të tyre dhe realizimit, përgatiten:

- 1) Plani nacional për mbrojtje të ajrit të ambientit (në tekstin e mëtejshëm: Plani);
- 2) plan për përmirësimin e kualitetit të ajrit të ambientit (në tekstin e mëtejshëm: plan për kualitetin e ajrit);
- 3) plan aksional afatshkurtër për mbrojtjen e ajrit të ambientit (në tekstin e mëtejshëm: plan aksional afatshkurtër) dhe
- 4) Programi nacional për reduktim gradual të sasive të emisioneve të

substancave të caktuara ndotëse, në nivel të Republikës së Maqedonisë (ne tekstin e mëtejme: Programi nacional për reduktim të emisioneve).

## **Neni 23-a**

### **Qëllimet e dokumenteve themelore të planit**

Qëllimi i dokumenteve themelore të planit nga neni 23 të këtij neni është që të arrihet:

- 1) qasje e integruar për mbrojtjen e kualitetit të ajrit të ambientit, ujit dhe dheut,
- 2) mbrojtja e shëndetit të njerëzve në mjedisin jetësor dhe të punës,
- 3) ikja nga efektet negative ndaj mjedisit jetësor mbi shtet fqinje dhe shtetet tjera

## **Neni 24**

### **Vlerësimi strategjik**

Vlerësimi strategjik i dokumenteve nga neni 23 i këtij ligji kryhet vetëm në raste dhe nën kushte të caktuara me Ligjin për ambientin jetësor.

## **Neni 25**

### **Plani nacional për mbrojtjen e ajrit të ambientit në Republikën e Maqedonisë**

(1) Me planin nacional nga neni 23 paragrafi (1) pika 1 e këtij ligji caktohet mbrojtja e ajrit të ambientit me të cilën posaçërisht do të sigurohet:

- 1) mirëmbajtja e kualitetit të ajrit të ambientit në zonat ku nuk tejkalohen vlerat kufitare për kualitet;
- 2) përmirësimi i kualitetit të ajrit të ambientit në zonat ku tejkalohen vlerat kufitare për kualitet;
- 3) ndërmarrja e masave për zvogëlimin e emisioneve nga burimet e caktuara stacionare të ndotjes;
- 4) miratimi i masave të domosdoshme për minimizimin dhe evitimin e tërësishëm të efekteve negative ndaj kualitetit të ajrit të ambientit;
- 5) miratimi i masave të domosdoshme për minimizimin dhe evitimin e tërësishëm të efekteve negative ndaj kualitetit të ajrit të ambientit në kontestin tejkufitar;
- 6) realizimi i obligimeve të ndërmarrja me marrëveshjen ndërkombëtare që i ka ratifikuar ose që u është kyçur Republika e Maqedonisë;
- 7) përcaktimi i zonave dhe aglomeracioneve me prioritet varësisht nga shkalla e tejkaloimit të vlerave kufitare për kualitet dhe varësisht nga rreziku ndaj shëndetit të njeriut, si dhe aktivitetet që duhet t'i ndërmarrin komunat dhe Qyteti i Shkupit.
- 8) ndërmarrja e masave për zvogëlimin e emisioneve nga djegia e lëndëve djegëse nga burimet në lëvizje; dhe
- 9) ndërmarrja e masave për mbrojtje nga emisionet e shkaktuara nga dukuritë natyrore.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e shëndetësisë dhe ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e ekonomisë e rregullon përmbajtjen detale dhe mënyrën e përgatitjes së Planit.

(3) Plani miratohet për një periudhë prej së paku pesë vitesh.

(4) Planin e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të organit të administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e shëndetësisë dhe organin e

administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e ekonomisë.

(5) Me propozim të organit të administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjekësisë dhe organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e ekonomisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë mund të bëjë ndryshime ose plotësime në Plan.

(6) Organi i administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor është organ përgjegjës për zbatimin e Planit nga paragrafi 1 i këtij neni.

(7) Organi i administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor është e obliguar që së paku një herë në çdo dy vjet ta njoftojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për realizimin e Planit.

(8) Përcaktimet e planit duhet të kihën parasysh gjatë përgatitjes së dokumenteve afatgjate me të cilat përcaktohet politika dhe qëllimet e shfrytëzimit dhe rregullimit të hapësirës si dhe zhvillimit të degëve të caktuara ekonomike.

## Neni 26

### Plani për kualitetin e ajrit

(1) Në pajtim me vlerësimin e kualitetit të ajrit të ambientit, në zonat dhe aglomeracionet e dhëna, ku nivelet e substancave ndotëse në ajrin e ambientit i tejkalojnë vlerat kufitare dhe qëllimore, si dhe cilëndo qoftë margjinë relevante të tolerancës, përpilohet Plan për kualitetin e ajrit për ato zona dhe aglomeracione, me qëllim që të arrihet vlerë përkatëse kufitare apo qëllimore.

(2) Planin për kualitetin e ajrit nga paragrafi (1) i këtij neni, e përpilon kryetari i komunës dhe i Qytetit të Shkupit në bashkëpunim me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor për periudhë prej pesë vjetësh.

(3) Për zonat dhe aglomeracionet që shtrihen në më shumë komuna, ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, në bazë të vlerësimit nga paragrafi (1) i këtij neni, me aktvendim e cakton komunën që do ta përpilojë Planin për kualitetin e ajrit në bashkëpunim me kryetarët e komunave tjera territoret e të cilave i takojnë zonës ose aglomeracionit. Kryetarët e komunave tjera që i takojnë asaj zone ose aglomeracionit, janë të obliguar që t'i japin në disponim të gjitha të dhënat që janë të domosdoshme, si dhe të sigurojnë mjete për përpilimin e Planit për kualitetin e ajrit.

(4) Në bazë të vlerësimit nga paragrafi (1) i këtij neni, ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton zonat dhe aglomeracionet për të cilat do të përpilohet plani, si dhe substancat ndotëse që do të përfshihen në plane.

(5) Në rast të tejkalimit të vlerave kufitare për të cilat afati i arritjes ka kaluar, në planet për kualitetin e ajrit përcaktohen masat përkatëse me qëllim që periudha e tejkalimit të jetë sa më e shkurtë që është e mundur.

(6) Planet për kualitetin e ajrit mund të përmbajnë edhe masa të posaçme për mbrojtjen e grupeve të ndjeshme të popullatës, duke i përfshirë edhe fëmijët.

(7) Në rast të tejkalimit të vlerave kufitare për kualitet për më shumë substanca ndotëse në një zonë ose aglomeracion, përpilohet Plan për kualitetin e ajrit i cili në mënyrë të integruar i përfshin të gjitha substancat ndotëse relevante.

(8) Gjatë përpilimit të Planeve për kualitetin e ajrit detyrimisht merren parasysh dokumentet e tjera të planit, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin me ajrin dhe mjedisin jetësor.

## Neni 27

### Përmbajtja e plani për kualitetin e ajrit

(1) plani për kualitetin e ajrit nga neni 23 paragrafi (1) pika 2 e këtij ligji i përmban elementet vijuese:

- 1) lokacionin e ndotjes përtej mase;
- 2) informatat e përgjithshme;
- 3) organet përgjegjëse;
- 4) natyrën dhe vlerësimin e ndotjes;
- 5) gjenezën e ndotjes;
- 6) analizën e gjendjes;
- 7) detaje për masat ose projektet për përmirësimin e kualitetit të ajrit të ambientit që ka ekzistuar para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- 8) detaje për masat e marra ose projekte nga aspekti i zvogëlimit të ndotjes, numërimit dhe përshkrimit të të gjitha masave të parapara në projekt; dhe
- 9) detaje për masat ose për projektet që planifikohen.

(2) plani për kualitetin e ajrit i përfshin qëllimet dhe afatet për realizim, mjetet e nevojshme financiare dhe organet përgjegjëse për kontroll dhe vlerësim të aktiviteteve të realizuara.

(3) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e shëndetësisë dhe ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e ekonomisë, e përcakton përmbajtjen e hollësishme dhe mënyrën e përgatitjes së plani për kualitetin e ajrit.

## Neni 27-a

### Plani aksional afatshkurtër

(1) Për zonat dhe aglomeracionet ku ekziston rrezik që nivelet e substancave ndotëse të tejkalojnë një ose më tepër nga pragjet për alarmim, përpilohen plane aksionale afatshkurtra, në të cilat përcaktohen masat të cilat duhet të ndërmerren në afat të shkurtër, sidomos për identifikimin e shkaqeve për dukuritë e shkaktuara që të zvogëlohet rreziku ose kohëzgjatja e tejkalimeve. Në zonat dhe aglomeracionet ku ky rrezik ka të bëjë me një ose më shumë substanca ndotëse, përpilohet plani aksional afatshkurtër, i cili në mënyrë të integruar i përfshinë të gjitha substancat ndotëse relevante.

(2) Planet aksionale afatshkurtra nga paragrafi (1) i këtij neni, i përpilojnë kryetari i komunës dhe kryetari i Qytetit të Shkupit në bashkëpunim me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor dhe me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e shëndetësisë.

(3) Për zonat dhe aglomeracionet që shtrihen në më shumë komuna, ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor në bazë të të dhënave për kualitetin e ajrit të ambientit, me aktvendim e cakton komunën që do ta përpilojë Planin afatshkurtër aksional në bashkëpunim me kryetarët e komunave tjera territoret e të cilave i takojnë zonës ose aglomeracionit. Kryetarët e komunave tjera që i takojnë asaj zone ose aglomeracionit, janë të obliguar që t'i japin në disponim të gjitha të dhënat që janë të domosdoshme, si dhe të sigurojnë mjete për përpilimin e planeve.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor në koordinim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e shëndetësisë e përcakton përmbajtjen e detajuar dhe mënyrën e përpilimit të planeve aksionale afatshkurtra.

(5) Për masat e ndërmarra, si dhe për çdo tejkalim të pragut të alarmimit, kryetari i komunës dhe i Qytetit të Shkupit në bashkëpunim me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e shëndetësisë, organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor dhe qendrën kompetente për njoftim dhe alarmim, në mënyrë të detyrueshme dhe në vazhdimësi e njofton publikun e prekur për gjendjen e krijuar, si dhe për masat të cilat duhet të ndërmerren, në mënyrë të përcaktuar me akt të komunës dhe të Qytetit të Shkupit.

## Neni 27-b

### Programi nacional për reduksion gradual të sasive të emisioneve të substancave të caktuara ndotëse

(1) Programi nacional për reduktimin e emisioneve nga neni 23 paragrafi (1) pika 4 e këtij ligji, përpilohet me qëllim të zvogëlimit progresiv të emisioneve nacionale vjetore të substancave të caktuara ndotëse në ajrin e ambientit, për periudhë të caktuar, dhe në të cilin përcaktohen masat për reduktimin e kufijve të sipërm-plafoneve të emisionit dhe projeksionet për reduktimin e sasive të emisioneve të substancave ndotëse në nivel vjetor në periudhën e caktuar.

(2) Në programin nacional për reduktimin e emisioneve përfshihen të dhënat për masat themelore dhe politikave miratuara dhe të parapara dhe vlerësimi i kuantifikuar i efekteve të politikave dhe masave për reduktimin e emisionit të substancave ndotëse në ajër.

(3) Në Programin nacional për reduktimin e emisioneve shënohen ndryshimet e emisioneve nacionale të substancave të dhëna ndotëse në ajër në çdo kuadrant të territorit të Republikës së Maqedonisë për tërë periudhën e caktuar.

(4) Krahas masave të përcaktuara nga paragrafi (2) i këtij neni mund të ndërmerren edhe masa të përkohshme për:

1) zvogëlimin e acidimit në kuadratet e territorit të Republikës së Maqedonisë ku ngarkesat kritike janë tejkaluara, masat e përkohshme mund të parashikohet me qëllim që të zvogëlohen sasitë e emisioneve për së paku 50% (në çdo kuadrant) në krahasim me kufijtë e caktuar - plafonët për emision për periudhën e caktuar dhe që të respektohen kufijtë e sipërm nacionalë-plafonët për emisionet;

2) zvogëlimin e ekspozimit të njerëzve në koncentrim të ozonit troposferik, kur sasia e ozonit troposferik është mbi nivelin kritik për shëndetin e njeriut mbi AOT60=0, masat e përkohshme mund të ndërmerren me qëllim që të zvogëlohet koncentrimi i ozonit troposferik për dy të tretat në të gjitha kuadrantët e territorit të Republikës së Maqedonisë në krahasim me kufijtë e caktuar të sipërm-plafonët për emisione për periudhën e caktuar, me ç'rast sasia e ozonit troposferik të mos e tejkalon kufirin prej 2,9 ppm•h, në cilindo qoftë kuadrant të territorit të Republikës së Maqedonisë;

3) zvogëlimin e ekspozimit në koncentrim të ozonit troposferik të vegjetacionit, kur ekspozimi i kulturave bujqësore dhe vegjetacionit në sasinë e ozonit troposferik është mbi nivelin kritik për të njëjtat, përkatësisht mbi AOT40=3 ppm•h, masat e përkohshme mund të ndërmerren me qëllim që të zvogëlohet koncentrimi i ozonit troposferik për një të tretën në të gjitha kuadrantët e territorit të Republikës së Maqedonisë në krahasim me kufijtë e caktuar të sipërm-plafonët për emisione për periudhën e caktuar, me ç'rast sasia e ozonit troposferik të mos e tejkalojë kufirin absolut prej 10 ppm•h, të shprehur si tejkalim i nivelit kritik prej 3 ppm•h në cilindo qoftë kuadrant të territorit të

Republikës së Maqedonisë dhe

4) zvogëlimin e eutrofikimit si masa të përkohshme me qëllim që të zvogëlohet eutrofikimi i tokës për 30% në krahasim me kufijtë e sipërm të caktuar- plafonët e emisioneve për periudhën e caktuar.

(5) Programi nacional për reduktimin e emisioneve mund të revidohet kur kjo të jetë e nevojshme, në periudhën kohore për të cilën është miratuar.

(6) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, me propozim të ministrit i cili udhëheq organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, e miraton Programin nacional për reduktimin e emisioneve.

## **Neni 27-v**

### **Zbatimi i Programit nacional për reduktimin e emisioneve**

(1) Me qëllim të zbatimit të Programit nacional për reduktimin e emisioneve që posedojnë leje të integruar ekologjike të lëshuar në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor gjatë përcaktimit të kufijve të sipërm-plafonë të emisioneve të substancave ndotëse të përcaktuara për periudhë të caktuar si bazë merren sasi të emisioneve për kohën reale vjetore të punës të instalimit, karburanti i përdorur dhe hyrja termike e instalimit, me vlerë të mesme të llogaritur të sasive për pesë vitet e fundit të punës.

(2) Mbyllja e një instalimi i cili ka qenë i përfshirë në Programin nacional për reduksion të emisioneve nuk nënkupton rritje të sasive vjetore individuale të emisioneve të substancave ndotëse të përcaktuara për periudhën e caktuar nga instalimet tjera të përfshira me program.

(3) Në Programin nacional për reduktim të emisioneve përfshihen të gjithë instalimet në Republikën e Maqedonisë të cilat posedojnë leje të integruar ekologjike të lëshuar në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor.

## **Neni 27-g**

### **Inventarizimi i emisioneve**

(1) Me qëllim që të përcaktohen sasi të kufijve të sipërm-plafonët e emisioneve të substancave ndotëse për periudhë të caktuar kryhet inventarizimi i emisioneve të territorit të Republikës së Maqedonisë.

(2) Inventarizimi i emisioneve të substancave ndotëse të territorit të Republikës së Maqedonisë kryhet nëpërmjet:

- 1) llogaritjes së sasive të emisioneve të substancave ndotëse në ajër në Republikën e Maqedonisë;
- 2) përgatitjes së Raportit për inventarizimin e emisioneve vjetore me projeksionet e emisioneve dhe
- 3) përgatitjes së Raportit për zbatimin e masave për zvogëlimin e emisioneve, me qëllim që të plotësohen obligimet ndaj Konventës për bartjen me shtrirje të gjerë tejkufitare të substancave ndotëse në ajër, të vitit 1979 dhe protokolleve të saj (në tekstin e mëtutjeshëm: konventa LRTAP).

(3) Në Raportin për inventarizimin e emisioneve vjetore të theksuara nga paragrafi (2) pika 2 të këtij neni përcaktohet edhe shpërndarja e emisioneve sipas – kuadrantëve në Republikën e Maqedonisë, me qëllim që të përcaktohet nëse ka ndryshime të rëndësishme në shpërndarjen hapësinore të emisioneve në nivel nacional.

## **Neni 27-d**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor çdo vit më së voni deri më 31 dhjetor, i

përgatit dhe i shpall llogaritë dhe raportet nga neni 27-g paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Llogaritë dhe raportet nga neni 27-g paragrafi (2) të këtij ligji dorëzohen te Agjencia Evropiane për Mjedis Jetësor dhe te organizata tjera relevante dhe te trupi ekzekutues i konventës LRTAP.

(3) Organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor rregullisht shkëmben të dhëna për sasitë e emisioneve të substancave ndotëse me organizatat ndërkombëtare, vendet nënshkruese të konventës LRTAP, trupat kompetentë dhe organizatat e Bashkimit Evropian

## Neni 28

### Obligimet e subjekteve të tjera

Personat fizikë dhe juridikë pronarë, gjegjësisht shfrytëzues të instalimeve që janë burime të ndotjes së ajrit të ambientit janë të obliguar t'i zbatojnë dhe financojnë masat për zvogëlimin emisioneve të përcaktuara në dokumentet e planeve nga neni 23 i këtij ligji.

## Neni 29

### Zonat parësore dhe aglomeracionet

Për zonat dhe aglomeracionet të cilat në pajtim me planin nga neni 25 paragrafi (1) pika 7 e këtij ligji janë caktuar si prioritare, programi me propozim të organit të administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor në bashkëpunim me komunat e afërta dhe Qytetin e Shkupit e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

## Neni 30

### Plan aksionar për gjendje alarmuese dhe obligimi për njoftim

*I fshirë* 3

## Neni 31

### Mbrojtja e integruar

Gjatë përgatitjes dhe realizimit të dokumentit të planit nga neni 23 i këtij ligji merren parasysh edhe rregullat për qasje të integruar ndaj mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe rregullat nga sfera e sigurimit shëndetësor si dhe rregulla të tjera relevante.

## Neni 32

### Bashkëpunimi

(1) Gjatë përpilimit të dokumenteve të planit nga neni 23 paragrafi (1) pikat 2 dhe 3 të këtij ligji komuna dhe qyteti i Shkupit, detyrimisht bashkëpunojnë me organet e administratës shtetërore, organizatat shkencore dhe profesionale duke i përfshirë edhe personat juridikë dhe fizikë pronarë, përkatësisht shfrytëzues të instalimeve të cilat janë burime të ndotjes së ajrit të ambientit.

(2) Kur vlerësimet kufitare dhe qëllimore të substancave ndotëse janë tejkualuar nga emisione nga vendet fqinje, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor në bashkëpunim me kryetarët e komunave dhe të qytetit të Shkupit, është i detyruar të bashkëpunojë me organet kompetente të shtetit fqinjë me qëllim të

përgatitjes së përbashkët të dokumenteve të planit nga neni 23 i këtij ligji.

(3) Në rast të tejkalimit të pragut të informimit dhe pragjeve të alarmimit në zonat dhe aglomeratet në afërsi të kufijve të Republikës së Maqedonisë, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor dhe komunat dhe qyteti i Shkupit mundësojnë këmbimin e informatave sa është e mundur më shpejtë me shtetet e prekura fqinje. Informatat që këmbehen janë të arritshme për publikun.

### **Neni 33**

#### **Lajmërimi dhe pjesëmarrja e opinionit publikut**

Kryetari i komunës dhe i Qytetit të Shkupit është i obliguar që t'i ndërmarrë të gjitha masat që ta informojë opinionin dhe të sigurojë qasje të informatat dhe pjesëmarrje në lidhje me përgatitjen dhe miratimin e dokumentet e planit nga nenet 26 dhe 27-a të këtij ligji në pajtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin për mjedis jetësor të cilat kanë të bëjnë me miratimin e dokumenteve të planit.

### **Neni 34**

#### **Dorëzimi i raporteve**

Prefekti i komunës dhe i Qytetit të Shkupit është i obliguar të dorëzojë te organi i administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor raport vjetor për zbatimin e dokumentet e planit nga nenet 26 dhe 27-a të këtij ligji.

### **Neni 35**

#### **Zonat me nivele më të ulëta nga vlerat e përcaktuara kufitare dhe qëllimore**

*I fshirë* 4

#### **Neni 35-a**

#### **Programi nacional për reduktim gradual të sasive të emisioneve të substancave të caktuara ndotëse**

*I fshirë*

#### **Neni 35-b**

#### **Realizimi i Programit nacional për reduktimin e emisioneve**

*I fshirë*

#### **Neni 35-v**

#### **Inventarët e emisioneve**

*I fshirë*

#### **Neni 35-g**

*I fshirë*

## **VI. MONITORIMI I KUALITETIT TË AJRIT TË AMBIENTIT DHE BURIMET E EMISIONEVE**



## Neni 36

### Qëllimet e monitorimit

(1) Monitorimi i gjendjeve dhe ndryshimet e kualitetit të ajrit të ambientit (në tekstin e mëtejshëm: monitorimi) kryhet në mënyrë dhe nën kushte të caktuara me këtë ligj.

(2) Qëllimi i monitorimit i kualitetit të ajrit të ambientit në Republikën e Maqedonisë është arritja e unitetit në krijimin dhe funksionimin e sistemeve për monitorim dhe kontroll dhe sigurimin për Bazat e të dhënave për ajrin përfshin të nevojshme për menaxhim dhe kontroll të gjendjeve me kualitetin e ajrit të ambientit përmes:

- 1) përcjelljes sistematike, mbikëqyrjes, kontrollit dhe vlerësimit të ndikimit të ndotjes ndaj kualitetit të ajrit të ambientit;
- 2) identifikimit dhe sistemimit të burimeve të ndotjes;
- 3) vlerësimit të ndikimit të ajrit të ndotur të ambientit ndaj shëndetit të njerëzve dhe mjedisit jetësor;
- 4) përcaktimit dhe propozimit të masave për përmirësimin e kualitetit të ajrit të ambientit;
- 5) shfrytëzimit të teknikave të tjera për vlerësim të kualitetit të ajrit të ambientit, posaçërisht modelimit dhe identifikimit të problemeve të ardhshme.

## Neni 37

### Rrjeti shtetëror

(1) Për monitorim të kualitetit të ajrit të ambientit në territorin e Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë krijon rrjet shtetëror për monitorim të kualitetit të ajrit të ambientit (në tekstin e mëtejshëm: rrjeti shtetëror).

(2) Me rrjetin shtetëror sigurohet monitorim i përhershëm i kualitetit të ajrit të ambientit që është pjesë përbërëse e monitorimit të përgjithshëm për mjedisin jetësor.

(3) Organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në sferën e mjedisit jetësor bën përcjelljen e ajrit të ambientit përmes rrjetit shtetëror dhe udhëheq me rrjetin shtetëror.

## Neni 38

### Programet për monitorim për kualitetin e ajrit të ambientit

(1) Për punën e rrjetit shtetëror, organ kompetent për kryerjen e punëve profesionale në sferën e mjedisit jetësor, miraton program vjetor për monitorim të kualitetit të ajrit të ambientit në pajtim me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Për realizimin e Programit nga paragrafi (1) i këtij neni, organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në sferën e mjedisit jetësor dorëzon raport vjetor te organi i administratës shtetërore kompetente për punët në sferën e mjedisit jetësor.

## Neni 39

### Rrjetet lokale

Për matjen dhe përcjelljen e ndotjes së ajrit të ambientit në lagjet dhe rajonet industriale komunat dhe qyteti i Shkupit kanë mundësi me marrje paraprake të mendimit nga organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor nën kushte dhe mënyra të

rregulluara me këtë ligj të vendosin rrjete lokale.

## **Neni 40**

### **Stacionet matëse dhe vendet matëse**

Monitorimi i kualitetit të ajrit të ambientit kryhet përmes stacioneve matëse dhe vendeve matëse për:

- 1) matjet e ndotjes në prapavijë (gjendja e kualitet të ajrit të ambientit në rajonet e pabanuara);
- 2) matja e ndotjes së ajrit të ambientit në rajone urbane dhe industriale, dhe sfera të cilat gjenden drejtpërdrejt afër rrugëve kryesore dhe udhëkryqe.
- 3) matja e ndotjes të ajrit së ambientit në rajone rurale.
- 4) matjet e bartjes tejkufitare të substancave ndotëse;
- 5) matjet në lidhje me obligimet ndërkombëtare të shtetit, dhe
- 6) matjet e ndotjes së ajrit të ambientit në rajonet e parqeve nacionale, parqet e natyrës, rajonet e mbrojtura, sistemet e ndejshme ekologjike, si dhe trashëgimisë kulturore e natyrore dhe matja e ndotjes së ajrit të ambientit në lagje dhe rajone industriale.

(2) Matjet e substancave ndotëse zbatohen në vazhdimësi në lokacione fikse ose me marrjen e ekzemplarëve me zgjedhje të rastit.

## **Neni 41**

### **Metodologjia e monitorimit dhe kriteret për përzgjedhjen e pikave matëse për të gjitha burimet e ndotjes**

(1) Mënyrën, kushtet dhe procedurën e vendosjes dhe punës së të gjitha rrjeteve dhe metodologjinë e monitorimit dhe kriteret për zgjedhjen e vendeve matëse për të gjitha burimet e ndotjes, kushtet, mënyrën dhe procedurën e dorëzimit të informatave dhe të dhënave nga monitorimi i kualitetit të ajrit të ambientit i rregullon ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët në sferën e shëndetësisë.

## **Neni 42**

### **Kryerja e monitoringut**

(1) Punët e caktuara profesionale për monitorimin e kualitetit të ajrit të ambientit mund t'i kryejnë edhe institucionet akredituese shkencore, organizatat profesionale dhe institucionet, si dhe persona të tjerë juridikë nën kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

(2) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni, për kryerjen e punëve të caktuara profesionale për monitorimin e kualitetit të ajrit të ambientit duhet t'i plotësojnë kushtet vijuese:

- 1) të kenë të punësuar së paku tre persona me përgatitje të lartë profesionale dhe përvojë të nevojshme të punës prej së paku tre vitesh nga sfera e monitorimit të kualitetit të ajrit, dhe
- 2) të kenë pajisje të nevojshme, aparate të lejuara në procedurën për verifikim të matësve të përcaktuar me ligj, instrumente dhe lokale përkatëse afariste për kryerjen e veprimtarisë.

(3) Kushtet më të përafërta për kryerjen e llojeve të caktuara të punëve profesionale, që ka të bëjë me pajisjen, instrumentet dhe lokalet përkatëse afariste që duhet t'i plotësojnë subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni i rregullon ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore

kompetente për punët nga sfera e shëndetësisë.

## Neni 43

### Kompetencat për monitorim në kontekst tejkuftar

Përcjellja dhe kontrolli i bartjes tejkuftare të substancave ndotëse në ajrin e atmosferës, si dhe ndikimi i ndotjes së ajrit të atmosferës ndaj proceseve klimatike në atmosferë e kryen organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në sferën e mjedisit jetësor dhe organi i administratës shtetërore kompetente për punët në sferën e hidro-meteorologjisë në pajtim me ligjin.

## Neni 44

### Dorëzimi i të dhënave dhe informacioneve

(1) Organet e administratës shtetërore, prefekti i komunës dhe i qytetit të Shkupit dhe subjektet tjera që kryejnë përcjelljen e kualitetit të ajrit të ambientit në pajtim me këtë ose ligj tjetër, janë të obliguar të dhënat dhe informatat e monitorimit, t'ia dorëzojnë pa kompensim organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në sferën e mjedisit jetësor dorëzon raporte nga monitorimi për nevojat e organit të administratës shtetërore kompetente për punët në sferën e shëndetësisë, enteve për sigurim social, dhe enteve qytetare për sigurim social, organit të administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e hidro-meteorologjisë, qendrave kompetente për lajmërim dhe alarmim, si dhe te prefekti i komunës dhe i qytetit të Shkupit, organet dhe institucione të tjera shtetërore.

(3) Organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në sferën e mjedisit jetësor, të dhënat dhe informatat e mbledhura, të përpunuara dhe të verifikuara nga monitorimi për kualitet të ajrit të ambientit dhe burimet e emisioneve, në pajtim me rregullën e miratuar në bazë të këtij ligji, i dorëzon së paku një herë në muaj e sipas nevojës edhe në afat më të shkurtër te organi i administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e mjedisit jetësor për shkak të realizimit të obligimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare që i ka ratifikuar ose të cilave u është bashkangjitur Republika e Maqedonisë, është organ kompetent për prezantimin e të dhënave për kualitetin e ajrit të ambientit dhe emisioneve në ajrin e ambientit.

## Neni 45

### Monitorimi i emisioneve nga burimet stacionare

(1) Personat juridikë dhe fizikë, pronar, gjegjësisht shfrytëzues të instalimeve të caktuara që janë burim i emisioneve të substancave ndotëse në ajrin e ambientit janë të obliguar të:

- 1) instalojnë dhe mirëmbajnë në gjendje të rregullt instrumentet matëse për përcjelljen e emisioneve në vendin e burimit, dhe
- 2) sigurojnë përcjellje të rregullt, matje dhe përpunim të të dhënave të emisioneve nga burimi i ndotjes dhe për të të mbajnë ditar.

(2) Të dhënat nga paragrafi (1) pika 2 e këtij neni, në organin kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor, i dorëzojnë subjektet që menaxhojnë me:

- instalimet me fuqi të instaluar prej 0 deri në 50 MW së paku një here në vit dhe
- instalimet me fuqi të instaluar mbi 50 MW, së paku një here në muaj, si

edhe raporte përmbledhëse vjetore.

(3) Me përjashtim nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, instalimet që kane emisione të substancave ndotëse në ajrin e mjedisit nga burimet stacionare me karakter difuziv, të dhënat nga emisionet mund t'i dorëzojnë në bazë të llogaritjeve ose në baze të matjeve.

(4) Formën dhe përmbajtjen e formularëve për dorëzimin e të dhënave nga emisionet në ajrin e mjedisit nga burime stacionare, mënyrën dhe periudhën kohore të dorëzimit në pajtim me kapacitetin e instalimit, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së ditarit të emisioneve në ajrin e mjedisit, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(5) Subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të obliguar t'i ruajnë të dhënat për emisionet së paku 5 vjet e pastaj t'i arkivojnë në pajtim me ligjin.

## **Neni 46**

### **Metodologjitë për monitorimin e emisioneve të burimeve stacionare**

(1) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor e rregullon metodologjinë, mënyrat, procedurat, metodat dhe mjetet për matjen e emisioneve nga burimet stacionare.

(2) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, cakton metodologjinë për inventarizimin dhe caktimin e niveleve të emisioneve të substancave ndotëse në ajrin e ambientit në ton për çdo vit për të gjitha llojet e veprimtarive, si dhe për të dhëna të tjera të nevojshme për dorëzim në Programin për monitorim të ajrit të Evropës (EMEP).

(3) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton sasinë e kufijve të larta - plafonët e emisioneve të substancave të ndotjes me qëllim të përcaktimit të projeksioneve për periudhë kohore të caktuar të cilat kanë të bëjnë me zvogëlimin e sasive të emisioneve të substancave ndotëse në nivel vjetor.

(4) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor përgjigjet për inventarizimin e nivelit nacional të emisioneve vjetore nga të gjitha substanca ndotëse për të cilat ekzistojnë të dhëna.

(5) Organi për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor mund të caktojë edhe institucion profesional për kryerjen e inventarizimit në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

## **Neni 47**

### **Monitorimi i kualitetit të ajrit të ambientit dhe burimet e emisioneve nga burimet e caktuara të veçanta stacionare**

(1) Personat juridikë dhe fizikë, pronar, gjegjësisht shfrytëzues të instalimeve të caktuara që janë burim i emisioneve të substancave ndotëse të ajrit të ambientit, të cilët nuk përfshihen në rrjetin shtetëror dhe/ose lokal për monitorim, janë të obliguar të ndërtojnë sistem për përcjelljen e burimit të emisioneve dhe kontroll të kualitetit të ajrit të ambientit në si edhe të vendosin në zonën më të afërt banesore e cila gjendet në drejtim të rese, së paku një stacion matës për cilësinë e ajrit të mjedisit në pajtim me lejen e integruar ekologjike.

(2) Personat nga paragrafi (1) të këtij neni përcjelljen dhe matjen mund ta kryejnë përmes shërbimeve vetjake ose përmes organizatave shkencore profesionale, ose persona të tjerë juridikë, nëse janë të akredituar për kryerjen e monitorimit të kualitetit të ajrit të ambientit, në pajtim me këtë ligj dhe ligj tjetër.

(3) Personat juridikë dhe fizikë të cilët udhëheqin me instalime që digjen janë të obliguar që veprimtaritë dhe aktivitete e tyre t'i zbatojnë në mënyrë me të cilën do të sigurohen masa për mbrojtjen e ajrit të ambientit nga ndotja, përmes zvogëlimit të emisioneve të substancave të veçanta ndotëse në ajër, planifikimi i masave që duhet të ndërmerren, si dhe zbatimi i metodave për matje të emisioneve.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor i përcakton kapacitetet që digjen të cilat duhet t'i ndërmarrin masat nga paragrafi (3) të këtij neni.

(5) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin i cili udhëheq me administratën shtetërore kompetent për ekonominë, i përcakton llojet e substancave ndotëse për të cilat përcaktohen vlerat kufitare të emisioneve, kufijtë më të lartë dhe qëllimet e zvogëlimit të llojeve e veçanta të substancave ndotëse, metodat e matjes së emisioneve, si dhe afatet për arritjen e vlerave kufitare të emisioneve të substancave ndotëse.

## VII. SISTEMI INFORMATIV

### Neni 48

#### **Sistemi informativ për kualitetin e ajrit të ambientit**

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor e vendos dhe menaxhon me sistemin unik informativ për kualitetin e ajrit të ambientit (në tekstin e mëtejme: sistemi informativ) që është pjesë e sistemit të përgjithshëm informativ për mjedisin jetësor.

(2) Të dhënat e grumbulluara, të përpunuara dhe të verifikuara nga neni 44 paragrafi (3) i këtij ligji, paraqesin bazë zyrtare të të dhënave për menaxhim dhe mbrojtje të kualitetit të ajrit të ambientit.

### Neni 49

#### **Baza e të dhënave për kualitetin e ajrit të ambientit**

(1) Baza e të dhënave për kualitetin e ajrit të ambientit përfshin:

- 1) të dhëna për kualitetin e ajrit të ambientit nga rrjetet shtetërore;
- 2) të dhënat për kualitetin e ajrit të ambientit nga rrjetet lokale;
- 3) të dhënat për emisionet nga burimet e lëvizshme;
- 4) të dhënat për emisionet për kualitetin e ajrit të ambientit nga burimet të caktuara stacionare;
- 5) të dhënat për emisionet nga burimet stacionare;
- 6) të dhënat për ndotjen e ajrit të ambientit në prag të alarmimit dhe masat për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të mjedisit jetësor;
- 7) të dhënat për kualitetin e ajrit të ambientit nga organizatat shkencore dhe profesionale dhe institucionet si dhe personat të tjerë juridikë.
- 8) të dhënat nga institucionet ndërkombëtare për përcjelljen e kualitetit të ajri i ambientit;
- 9) të dhënat nga organet shtetërore, organizatat shkencore dhe profesionale dhe institucionet dhe personat të tjerë juridikë që kryejnë matjen dhe përcjelljen e kualitetit të ajrit të ambientit prej të gjitha burimeve të ndotjes dhe;
- 10) të dhëna nga vlerësimi i kualitetit të ajrit të ambientit.

## Neni 50

### Informimi i publikut

(1) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, përmes Qendrës maqedonase informative për mjedisin jetësor, përgatit dhe publikon raporte vjetore për emisione, raporte vjetore për kualitetin e ajrit të ambientit dhe raporte periodike për implementimin e obligimeve të këtij ligji, në pajtim me ligjin dhe rregull tjetër, si dhe lloje tjera të raporteve në pajtim me obligimet nga marrëveshjet ndërkombëtare, që i ka ratifikuar apo të cilat ka pranuar Republika e Maqedonisë.

(2) Organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar t'i publikojë programet për monitorimin e kualitetit të ajrit të ambientit.

(3) Prefekti i komunës dhe i Qytetit të Shkupit është i obliguar t'i publikojë dokumentet e planit nga nenet 26 dhe 27-a të këtij ligji, si dhe të informojë për masa të tjera për menaxhim me kualitetin e ajrit të ambientit dhe masat dhe aktivitetet për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në rajonin e vet, të realizuara në vitin paraprak dhe aktivitetet e parashikuara për vitin e ardhshëm.

(4) Ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punën nga sfera e mjedisit jetësor, përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e bartjes së të dhënave dhe informatave për gjendjet në menaxhimin me kualitetin e ajrit të ambientit.

(5) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, është i obliguar që gjatë vitit ta informojë me kohë dhe në mënyrë të saktë publikun për gjendjen momentale të kualitetit të ajrit të ambientit, përparimin e arritur, planet dhe drejtimet e ardhme për përmirësimin e gjendjes, si dhe të bëjë krahasimin dhe vlerësimin e gjendjes aktuale me gjendjen e kaluar në menaxhimin me kualitetin e ajrit të ambientit.

(6) Në rast të tejkalimit së pragut të informimit dhe pragut të alarmimit në zonat afër kufijve me shtetet fqinje, në afat sa më të shkurt të mundshëm, duhet të sigurohen informata për organet kompetente në vendet e prekura fqinje me qëllim që të sigurohen informata për opinionin nga ato vende

## Neni 51

### Qasje në informata

(1) Të dhënat dhe informatat nga sistemi informativ për kualitetin e ajrit të ambientit, janë informata të arritshme për publikun.

(2) Organet kompetente dhe personat tjerë juridikë, të cilët kanë të dhëna dhe informata për kualitetin e ajrit të ambientit, janë të obliguar të sigurojnë qasje të publikut deri te të dhënat dhe informatat, në formën e përcaktuar, në mënyrë dhe procedurë të caktuar në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor dhe ligj tjetër.

## Neni 52

### Kadastrin e ndotësve të ajrit

(1) Për vërtetimin e shkallës së ndotjes së ajrit të ambientit, burimet e ndotjes si dhe nivelin e ndikimit të dëmshëm ndaj kualitetit të ajrit, themelohet Kadastrin e ndotësve të ajrit (në tekstin e mëtejshëm: Kadastrin).

(2) Kadastrin e udhëheq dhe mban organi kompetent për kryerjen e punëve profesionale në sferën e mjedisit jetësor.

(3) Kadastri i përmban të dhënat vijuese:

- 1) të dhënat themelore për personat fizikë dhe juridikë që kanë instalime të cilat janë burime për ndotjen e ajrit të ambientit;
- 2) lokacionin e objektit;
- 3) përshkrimin e shkurtër të aktiviteteve dhe procesit tekniko-teknologjik;
- 4) të dhënat e rëndësishme që u dedikohen emisioneve të substancave ndotëse;
- 5) të dhënat që i dedikohen pajtueshmërisë, lejeve dhe ndryshimeve në leje dhe pajtueshmërive dhe të dhënat e tjera relevante;
- 6) listën e substancave potenciale ndotëse me të cilat çrregullohet ose mund të çrregullohet kualiteti i ajrit të ambientit;
- 7) të dhënat për kontrollet e kryera, rezultate të rëndësishme dhe masa të ndërmarra.

(4) Formën, metodologjinë dhe mënyrën e menaxhimit dhe mbajtjes së Kadastrit i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(5) Për shkak të nevojës së themelimit dhe udhëheqjes së Kadastrit, personat juridikë dhe fizikë janë të obliguar që të dhënat nga paragrafi (3) i këtij neni, si dhe të dhënat tjera të nevojshme t'ia dorëzojnë organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor me kërkesën të tij.

(6) Të dhënat nga Kadastri janë të arritshme për publikun në volum, formën dhe mënyrën e përcaktuar me rregull të nxjerrë në bazë të Ligjit për mjedisin jetësor.

(7) Kadastri nga paragrafi (1) i këtij neni, është pjesë përbërëse e Kadastrit për mjedisin jetësor.

## VIII. MBROJTJA E AJRIT TË AMBIENTIT NGA NDOTJA

### **Neni 53**

#### **Ndalimi**

Ndalohet lëshimi i emisioneve të substancave ndotëse mbi vlerat e përcaktuara kufitare të përcaktuara me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji, të cilat shkaktojnë pasoja të dëmshme për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin jetësor.

### **Neni 54**

#### **Ndalimi i rreptë**

(1) Emisioni i substancave ndotëse në ajrin e ambientit mund të kryhet vetëm në mënyrë e cila është përcaktuar me këtë ligj ose me lejet për harmonizim me planin operativ ose lejet e integruara ekologjike të lëshuara në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të zbatohen vlerësime më të rrepta kufitare nëse ato janë përcaktuar në planet afatshkurtra aksionale nga neni 27-a i këtij ligji ose në kushte të shkaktit të fatkeqësisë ose avarisë.

## 1. MBROJTJA E AJRIT TË AMBIENTIT NGA NDOTJA NGA BURIMET STACIONARE

### **Neni 55**

## Burimet stacionare të ndotjes

(1) Për instalimet që bëjnë ndotjen e ajrit të ambientit për të cilat në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor janë të nevojshme leje A dhe B të integruara ekologjike, lejet merren në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me Ligjin për mjedisin jetësor.

(2) Për projektet për të cilat, në pajtim me listën nga dispozita e përcaktuar në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor, kryhet vlerësimi i ndikimit ndaj mjedisit jetësor, si dhe për projektet për të cilat nevoja e vlerësimit të ndikimit caktohet me hulumtimin e çdo rasti të veçantë, procedura për vlerësimin e ndikimit zbatohet nën kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me Ligjin për mjedisin jetësor.

### Neni 56

#### Instalimet ekzistuese

(1) Operatorët e instalimeve të caktuara ekzistuese që janë burim i ndotjes së ajrit të ambientit dhe të cilët në bazë të veprimtarisë së tyre përmes emisioneve bëjnë ndotjen e ajrit të ambientit dhe të cilat për shkak të nivelit të zhvillimi tekniko-teknologjik dhe llojit të lëndës së parë që përdoren, nuk mund t'i arrijnë vlerat e përcaktuara kufitare për emision, në pajtim me dispozitën e nxjerrë në bazë të këtij ligji, janë të obliguar të sigurojnë leje për harmonizim me planin operativ si kusht për vazhdimin, përkatësisht fillimin e punës së instalimit në procedurën përcaktuar me Ligjin për mjedisin jetësor.

### Neni 56-a

#### Masa për mbrojtje gjatë djegies së mbeturinave

(1) Ndalohet djegia e mbeturinave në hapësirë nën qiell të hapur.

(2) Djegia e mbeturinave bëhet në instalime për atë dedikim me ç'rast emisionet nga djegia në ajrin e ambientit duhet të jetë në suazat e vlerave kufitare të përcaktuara nga neni 13 të këtij ligji.

### Neni 57

#### Instalime të tjera

(1) Objektet dhe instalimet për të cilat nuk është paraparë dhënia e lejeve të integruara ekologjike në pajtim me ligjin, ndërtohen, pajisen dhe mirëmbahen në mënyrë me të cilën pengohet, zvogëlohet dhe kontrollohet ndikimi negativ ndaj kualitetit të ajrit të ambientit.

(2) Ministri i cili udhëheqë me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor, përcakton mënyrën dhe masat për preventimin dhe pengimin e ndotjes së ajrit të ambientit nga objektet dhe instalimet nga paragrafi (1) këtij neni.

## 2. MBROJTJA E AJRIT TË AMBIENTIT NGA BURIMET E LËVIZSHME

### Neni 58

#### Burimet e lëvizshme të ndotjes

(1) Pronarët e burimeve të lëvizshme të ndotjes janë të obliguar të sigurojnë harmonizim me vlerat kufitare dhe qëllimore për emisionet e burimeve të lëvizshme, që janë përcaktuar për çdo lloj të veçantë të burimit të ndotjes së ajrit të ambientit në pajtim me neni 14 i këtij ligji.



(2) Gjatë kontrollit teknik dhe regjistrimit të burimeve lëvizëse të ndotjes, detyrimisht kryhet kontrolli i rregullt i harmonizimit të niveleve të emisioneve nga burimet lëvizëse me vlerësimet e përcaktuara kufitare dhe qëllimore për emision nga ky lloj i burimeve.

(3) Kontrolli i harmonizimit të emisioneve të burimeve të veçanta të lëvizshme të ndotjes mund të kryhet edhe përmes kontrollit të çrregullt, në rastet kur të dhënat e monitorimit ose të dhënat tjera tregojnë se ekziston rrezik real nga tejkalimi i vlerave të përcaktuara kufitare dhe qëllimore për kualitet dhe pragjet e alarmimit.

## **Neni 59**

### **Masat tjera për mbrojtje nga burimet e lëvizshme**

(1) Ministri i cili udhëheqë me organin e administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e shëndetësisë në pajtim me ministrin i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e bujqësisë dhe pylltarisë, mund ta kufizojë ose ta ndalojë kryerjen e veprimeve të caktuara dhe përdorimin e prodhimit bimor që kultivohet në tokë, përgjatë rrugëve, nëse ndotja e ajrit nga mjetet motorike të transportit ka ndikim ndaj tyre, në pajtim me rregullat për sigurimin e ushqimit.

(2) Ministri që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor në pajtim me ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punëve të brendshme dhe ministrin që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e shëndetësisë, mund ta kufizojë ose ndalojë komunikacionin në vende të caktuara në rajone urbane dhe/ose rurale për kohëzgjatje të caktuar në qoftë se përqendrimi i substancave ndotëse në ajrin e ambientit i tejkalon pragjet e alarmimit, deri sa nuk arrihen vlerat kufitare.

## **3. OBLIGIMET PËR NDËRMARRJE TË MASAVE TJERA PËR NDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E NDOTJES SË AJRIT TË AMBIENTIT**

### **Neni 60**

#### **Obligime të tjera**

(1) Personat juridikë dhe fizikë pronarë, përkatësisht shfrytëzues të instalimeve dhe burime të ndotjes së ajrit të ambientit janë të obliguar:

1) ta lajmërojnë më së voni në afat prej 30 ditëve organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor për burimin e ndotjes së ajrit të ambientit, lëndëve të para dhe proceseve teknologjike dhe pajisjeve, si dhe për ndryshimet vijuese në lëndët e para dhe proceset teknologjike që do të sjellin deri në ndryshime në kushtet dhe kërkesat për ruajtjen e kualitetit të ajrit të ambientit si dhe gjatë kryerjes së punëve të meremetimit të aparateve për pastrimin e ajrit të ambientit dhe pajisjen;

2) ta lajmërojnë organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor më së voni në afat prej 30 ditëve nga krijimi i ndryshimeve në lëndën e veprimtarisë, si dhe për ndryshimin e operatorit të instalimit dhe të personave përgjegjës për ruajtjen e mjedisit jetësor;

3) pa shtyrje dhe menjëherë ta lajmërojnë Inspektoratin shtetëror për mjedisin jetësor dhe Inspektoratin sanitar shtetëror shëndetësor për avarinë në prodhimtari, si dhe për incidentet tjera që mund të sjellin deri në zmadhimin e emisioneve ose të nxisin keqësimin e kualitetit të ajrit të ambientit, si dhe të ndërmarrin masa, në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat që rregullojnë këtë materie gjatë krijimit të avarisë ose fatkeqësisë dhe

4) të sigurojnë qasje të pakufizuar të inspektorëve kompetentë te burimet

ndotëse të ajrit të ambientit si dhe të të gjitha dokumentet dhe të dhënat të lidhura me emisionet dhe t'u ofrojnë ndihmë gjatë kryerjes së funksioneve të tyre.

(2) Të dhëna nga paragrafi (1) pika 1 dhe 2 të këtij neni i dërgohen prefektit të komunës dhe të Qytetit të Shkupit për instalimet për të cilat në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor, është e nevojshme leja B ekologjike e integruar, përkatësisht leja për harmonizim me planin operativ.

## **Neni 61**

### **Stabilimente për zbrazje**

(1) Burimet stacionare të emisioneve duhet t'i zbrazin emisionet në ajrin e ambientit të kontrolluar, përmes stabilimenteve adekuate të konstruara për zbrazjen e gazrave.

(2) Emisionet, që lëshohen nga një burim stacionar për të cilin është e nevojshme dhënia e lejes A të integruar ekologjike në pajtim me Ligjin për mjedis jetësor, nuk duhet të tejkalojnë më shumë se 25% nga vlerësimet e përcaktuara kufitare për kualitet të ajrit, me ç'rast, caktimi përfundimtar i pjesëmarrjes së emisioneve që lëshohen nga ai burim stacionar caktohet në lejet për harmonizimin me planin operativ përkatësisht lejet e integruara ekologjike.

## **Neni 62**

### **Mbrojtja nga dëmtimet**

Çdo person fizik dhe juridik që është pronar ose kryerës i veprimtarisë në procesin e prodhimit (në tekstin e mëtejme: operatori), sistemit transportues ose për magazinim (në tekstin e mëtejme: sistem) ku janë të pranishme substancat e dëmshme dhe të rrezikshme, e të cilat menjëherë ose me veprim të shtyrë mund të iniciojnë rrezik serioz për shëndetin e njeriut, përkatësisht mjedisin jetësor, në sistem ose jashtë sistemit, si rezultat i lëshimit të një ose më shumë substancave të dëmshme dhe të rrezikshme në ajrin e ambientit, janë të obliguar që në planet e brendshme për gjendje të jashtëzakonshme, në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor, të parashikojnë masa që duhet të ndërmerren për mbrojtjen e kualitetit të ajrit të ambientit gjatë avarive të mundshme.

## **IX. FINANCIMI**

### **Neni 63**

#### **Burimet e financimit**

(1) Mjetet për mbrojtjen dhe përmirësimin e kualitetit të ajrit të ambientit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë edhe burime të tjera të mjeteve të caktuara me ligj.

(2) Me mjetet nga paragrafi (1) i këtij neni, financohet realizimi i Planit nacional për mbrojtjen e ajrit të ambientit në Republikën e Maqedonisë, programi për monitorimin e kualitetit të ajrit të ambientit dhe masave tjera që ndërmerren në bazë të këtij ligji.

(3) Mjetet për realizimin e programit në zonat prioritare dhe aglomeracionet nga neni 29 i këtij ligji, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe burimeve të tjera të mjeteve të përcaktuara me ligj.

(4) Mjetet për formimin, punën, punën, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit shtetëror, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe burime të tjera të mjeteve të përcaktuara me ligj.

## Neni 64

### Mjetet nga buxhetet e njësive të vetadministrimit lokal

(1) Në buxhetin e komunave dhe Qytetit e Shkupit sigurohen mjetet për mbrojtje dhe përparimin e kualitetit të ajrit të ambientit si dhe burime tjera të mjeteve të përcaktuara me ligj.

(2) Me mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni sigurohet realizimi i dokumentet e planit nga nenet 26 dhe 27-a të këtij ligji, zbatimi i aktiviteteve në zonat parësore dhe aglomeracionet nga neni 29 i këtij ligji, si dhe për masa të tjera që ndërmerren në bazë të këtij ligji.

(3) Mjetet për formim, punën, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjeteve lokale nga neni 39 i këtij ligji, sigurohen nga buxhetet e komunave dhe Qyteti i Shkupit dhe burime të tjera të mjeteve të përcaktuara me ligj.

## X. MBIKËQYRJA DHE ORGANET KOMPETENTE

### Neni 65

#### Organet kompetente

(1) Mbikëqyrje ndaj zbatimit të këtij ligji dhe dispozitave e miratuara në bazë të këtij ligji, kryen organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(2) Mbikëqyrje inspektuesndaj zbatimit të këtij ligji dhe dispozitave të miratuara në bazë të këtij ligji, kryen Inspektorati shtetëror për mjedisin jetësor përmes inspektorëve të mjedisit jetësor.

(3) Për punët nga kompetenca e komunave dhe Qytetit të Shkupit të përcaktuara me këtë ligj, mbikëqyrje inspektuese ndaj zbatimit të këtij ligji, kryejnë inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësor të komunave dhe inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësor të Qytetit të Shkupit.

(4) Kontrollin e rregullt të emisioneve nga burimet e lëvizshme të ndotjes, e kryen organi kompetent për përcaktimin e rregullsisë teknike të burimeve të posaçme të lëvizshme, në pajtim me këtë ligj ose ligj tjetër.

(5) Kontrollin e jashtëzakonshëm ndaj emisioneve të burimeve të lëvizshme të ndotjes, kryen inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor të komunave dhe inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor nga Qyteti i Shkupit në bashkëpunim me organin kompetent për përcaktimin e rregullsisë teknike të burimeve të posaçme të lëvizshme, në pajtim me këtë ligj ose ligj tjetër.

(6) Kontrollin e rregullsisë shëndetësore të prodhimit të bimëve që kultivohet në tokë përgjatë rrugës, si dhe në rastet kur gjatë vlerësimit të kualitetit të ajrit të ambientit është caktuar se ekziston rrezik shëndetësor për jetën dhe shëndetin e njerëzve, e kryen organi kompetent për ndërmarrjen dhe zbatimin e masave të nevojshme është Inspektorati shtetëror sanitar dhe shëndetësor në kuadrin e autorizimeve të caktuara me ligj.

(7) Kontrollin e kualitetit të lëndëve djegëse sa u përket vlerave të përcaktuara kufitare për përmbajtjen e substancave të dëmshme dhe kërkesave të tjera për kualitetin e lëndëve djegëse, e kryen Inspektorati shtetëror i tregut në kuadrin e autorizimeve të përcaktuara me ligj.

(8) Kontrolli i drejtpërdrejtë dhe mbikëqyrja e emisioneve të instalimeve të caktuara dhe burimeve të ndotjes së ajrit të ambientit, kryhet së paku dy herë në vit, ndërsa ndaj burimeve të lëvizshme bëhet kontroll i rregullt së paku një herë në vit.

(9) Inspektorët shtetërorë për mjedisin jetësor dhe inspektorët e

autorizuar për mjedisin jetësor, mbikëqyrjen inspektuese në sferën e administrimit me kualitetin e ajrit të ambientit e zbatojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji Ligjit për mbikëqyrje inspektuese dhe Ligjit për mjedisin jetësor.

## Neni 66

### Fushëveprimi i Inspektoratit shtetëror për mjedisin jetësor

(1) Për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese nga fushëveprimi i tij, Inspektorati shtetëror për mjedisin jetësor (në tekstin e mëtejshëm: inspektori për mjedisin jetësor) ka të drejtë:

- 1) të kryejë shikim dhe kontroll se a janë plotësuar kushtet për mbrojtjen dhe përmirësimin e kualitetit të ajrit të ambientit të përmbajtura në lejen A të integruar ekologjike (neni 55), përkatësisht lejen për harmonizim me planin operativ (neni 56);
- 2) të vërtetojë se a i plotëson kryerësi i punëve të caktuara profesionale për monitorimi në kualitetit të ajrit të ambientit kushtet për kuadrin e nevojshëm, pajisen dhe instrumentet për kryerjen e këtij lloji të punëve (neni 42 paragrafi 2);
- 3) të bëjë kontroll dhe shikim se a ka instaluar dhe se a mirëmbahen në mënyrë të drejtë instrumentet matëse për përcjelljen e emisioneve (neni 45 paragrafi 1 pika 1);
- 4) të vërtetojë se a është ruajtur procedura për mënyrën dhe shpeshtimin e matjes së emisioneve, përkatësisht llogaritjen e sasisë së emisioneve dhe mënyrën e mbajtjes së ditarit (neni 45 paragrafi (1) pika 2);
- 5) të vërtetojë se a i dërgohen të dhënat për emisionet organit kompetent (neni 45 paragrafi 2);
- 6) të vërtetojë se a është ndërtuar sistemi për përcjelljen e burimit të emisioneve dhe kontrollit të kualitetit të ajrit të ambientit në rajonin e objektit (neni 47 paragrafi 1);
- 7) të konstatojë nëse subjektet që posedojnë të dhëna dhe informata për cilësinë e ajrit të mjedisit, sigurojnë qasje në informatat për cilësinë e ajrit të mjedisit të cilat i posedojnë dhe nëse e kanë bërë atë në afatin dhe formën e përcaktuar (neni 51 paragrafi (2));
- 8) të konstatojë nëse me kërkesë të organit kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor, i dorëzohen të dhënat e nevojshme për përpilimin dhe mbajtjen e Kadastrës së ndotësve të ajrit (neni 52 paragrafi (5));
- 9) të përcakton nëse është respektuar procedura për djegien e mbeturinave (neni 56-a)" në pajtim me këtë ligj.
- 10) përcakton nëse janë realizuar kërkesat nga neni 61 paragrafi (2) i këtij ligji dhe
- 11) të ndërmarrë edhe masa të tjera për të cilat është i autorizuar me ligj.

(2) Me kërkesën e inspektorit për mjedisin jetësor personi i autorizuar i organit të administratës shtetërore kompetente për punë të brendshme, është i obliguar të marr pjesë në kryerjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni.

## Neni 67

### Marrja e vendimeve të inspektorit shtetëror për ambientin jetësor

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së inspektuese, inspektori për mjedisin jetësor me vendim:

- 1) do ta përkufizojë ose ndalojë punën e instalimit nëse nuk janë plotësuar kushtet për mbrojtjen e ajrit të ambientit nga ndotja të përmbajtura në lejen A ekologjike të integruar (neni 55), përkatësisht kushtet e përmbajtura në lejen për harmonizim me planin operativ (neni 56) në afat prej së paku 60 ditëve, afat në të cilin duhet të mënjanohe shkaqet për gjendjen e krijuar;

2) do ta përkufizojë ose ndalojë punën e personit juridik, i cili kryen punë të caktuara profesionale për monitorimin e kualitetit të ajrit të ambientit nëse nuk i plotëson kushtet për kryerjen e këtij lloji të punëve (neni 42 paragrafi (2) në kohëzgjatje prej më shumë se 30 ditëve, afat në të cilin duhet t'i evitohet shkaqet për gjendjen e krijuar;

3) do ta përkufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë që nuk kanë instaluar instrumente matëse për përcjelljen e emisioneve ose të njëjtat janë në gjendje të parregullt (neni 45 paragrafi (1) pika 1), në kohëzgjatje prej më së shumti prej 30 ditëve afat në të cilin duhet t'i mënjanohet shkaqet për gjendjen e krijuar;

4) do ta përkufizojë ose ndalojë punën e personit juridik ose fizik nëse nuk e ruan procedurën, mënyrën dhe shpeshësinë e matjes së emisioneve, përkatësisht llogaritjen e sasisë së emisioneve dhe mënyrën e mbajtjes së ditarit (neni 45 paragrafi (1) pika 2) në kohëzgjatje prej më shumë se 30 ditëve, afat në të cilin duhet t'i mënjanohet shkaqet për gjendjen e krijuar;

5) do ta përkufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë nëse vërtetohet se nuk kanë paraqitur të dhëna për emisionet (neni 45 paragrafi (2) në kohëzgjatje prej më së shumti prej 30 ditëve, afat në të cilin duhet t'i evitohet shkaqet për gjendjen e krijuar;

6) do ta përkufizojë ose ndalojë punën e personave fizikë ose juridikë nëse vërtetohet se nuk është ndërtuar sistemi për përcjelljen e burimit të emisioneve dhe kontrollit të kualitetit të ajrit të ambientit në rajonin e objektit (neni 47 paragrafi (1) në kohëzgjatje prej më së shumti prej 30 ditëve, afat në të cilin duhet t'i evitohet shkaqet për gjendjen e krijuar;

7) do t'i ngarkojë të sigurojnë qasje në informatat për cilësinë e ajrit të mjedisit të cilat i posedojnë në afatin dhe formën e përcaktuar (neni 51 paragrafi (2));

8) do t'i ngarkojë personat juridike dhe fizikë që t'i dorëzojnë të dhënat e nevojshme për përpilimin dhe mbajtjen e Kadastrës së ndotësve të ajrit, në afat prej më së shumti 30 ditësh prej ditës së konstatimit të mangësisë (neni 52 paragrafi (5));

9) do ta ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë në qoftë se konfirmon se nuk është respektuar procedura për djegien e mbeturinave (neni 56 a)

10) do ta kufizojë ose ndalojë punën e instalimit nëse nuk janë plotësuar kërkesat nga neni 61 paragrafi (2) të këtij ligji, në kohëzgjatje prej më së shumti 30 ditësh në të cilin afat duhet t'i mënjanohet arsyet për gjendjen e shkaktuar dhe

11) Do ta obligojë personin juridik ose fizik i cili nuk i plotëson kushtet për mbrojtjen e ajrit në pajtim me këtë ligj t'i ndërmarrë masat e duhura dhe do t'i caktojë afat për plotësimin e të njëjtave.

(2) Në rastin kur do të vërtetohet ekzistimi i rrezikut të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e njerëzve, inspektori për mjedisin jetësor do të japë urdhër me gojë për mënjanimin urgjent dhe të pa prolongim të mangësive të caktuara, të cilat me procesverbal i konstaton në bashkëpunim me Inspektoratin shtetëror sanitar shëndetësor, si dhe do t'i lajmërojë edhe inspektoratet tjerë kompetentë ose organet tjera shtetërore për parregullsitë e përcaktuara dhe do të kërkojë intervenimin e tyre.

(3) Në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni inspektori për mjedisin jetësor merr vendim me shkrim në afat prej 48 orëve nga dhënia e urdhërit me gojë;

(4) Nëse edhe për herë të dytë gjatë vitit është bërë thyerja e paragrafit (1) pika 2 e këtij nenin, atëherë inspektori për mjedisin jetësor do të shqiptojë ndalim për kryerjen e veprimtarisë në afat prej më shumë se 60 ditë, afat në të cilin duhet të mënjanohen shkaqet për gjendjen e krijuar;

(5) Për kryerjen e punëve nga paragrafi (1) pika 1 e këtij neni, inspektori për mjedisin jetësor ka të drejtë për ndërmarrjen edhe të masave të tjera të përcaktuara me Ligjin për mjedisin jetësor.

## Neni 68

## **Fushëveprimi i inspektorëve të autorizuar për mjedisin jetësor**

(1) Për kryerjen e mbikëqyrjes së inspektimit nga fushëveprimi i tij, inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor i komunës dhe inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor i Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejshëm: inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor) ka të drejtë:

- 1) të kryejë mbikëqyrje se a janë plotësuar kushtet për mbrojtjen dhe përmirësimin e kualitetit të ajrit të ambientit të përfshira në lejen B të integruar ekologjike (neni 55), përkatësisht lejen për harmonizim me planin operativ (neni 56);
- 2) të bëjë kontroll dhe mbikëqyrje se a ka të instaluar dhe a mirëmbahen instrumentet matëse për përcjelljen e emisioneve (neni 45 paragrafi (1) pika 1);
- 3) të vërtetojë se a është ruajtur procedura dhe mënyra e shpeshësisë së matjes të emisioneve, përkatësisht llogaritja e sasisë së emisioneve dhe mënyra e mbajtjes së ditarit (neni 45 paragrafi (1) pika 2);
- 4) të vërtetojë se a i paraqiten të dhënat e emisioneve organit kompetent (neni 45 paragrafi (2));
- 5) të bën kontroll dhe shikim se a janë plotësuar kushtet me të cilat pengohet, zvogëlohet ose kontrollohet ndikimi negativ ndaj kualitetit ajrit të ambientit të instalimeve për të cilat nuk është paraparë dhënia e lejeve të integruara ekologjike (neni 57) dhe;
- 6) të vërtetojë nëse është respektuar procedura për djegien e mbeturinave (neni 56-a)
- 7) të ndërmarrë edhe masa të tjera për të cilat është i autorizuar me ligj.

(2) Me kërkesën e inspektorit të autorizuar për mjedisin jetësor, personi i autorizuar i organit të administratës shtetërore kompetent për punët e brendshme, është i obliguar të marrë pjesë në kryerjen e punëve nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor kryerjen e punëve nga mbikëqyrja e inspektimit nga paragrafi (1) pika 1, 2, 3 dhe 4 i ndërmerr te instalimet, të cilat në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor duhet të posedojnë leje B të integruar ekologjike.

### **Neni 69**

#### **Marrja e vendimit nga inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor**

(1) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor me vendim:

- 1) do ta përkufizojë ose ndalojë punën e instalimit nëse nuk janë plotësuar kushtet për ruajtjen e vlerave të përcaktuara kufitare të për emision të përcaktuara në lejen B ekologjike të integruar (neni 55), përkatësisht kushtet për ruajtjen e vlerave të përcaktuara kufitare për emision të caktuar me lejen për harmonizim me planin operativ (neni 56) në kohëzgjatje prej më së shumti deri në 30 ditëve, afat në të cilin duhet të mënjanohen shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 2) do ta përkufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë që nuk kanë instaluar instrumente matëse për përcjelljen e emisioneve ose të njëjtat janë në gjendje të parregullt (neni 45 paragrafi (1) pika 1) në kohëzgjatje prej më shumë se 30 ditëve, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 3) do ta përkufizojë ose ndalojë punën e personit juridik ose fizik nëse nuk e ruan procedurën, mënyrën dhe shpeshësinë e matjes së emisioneve, përkatësisht llogaritjen e sasisë së emisioneve dhe mënyrën e mbajtjes së ditarit (neni 45 paragrafi (1) pika 2) në afat prej më së shumti prej 30 ditëve, afat në të cilin duhet t'i mënjanojë shkaqet për gjendjen e krijuar;
- 4) do ta përkufizojë ose ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë nëse vërteton se nuk i kanë paraqitur të dhëna për emisionet organit kompetent (neni 45 paragrafi (2) në afat prej më së shumti prej 30 ditëve, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar;

5) do ta përkufizojë ose ndalojë punën e instalimit nëse nuk janë plotësuar kushtet me të cilat pengohet, zvogëlohet ose kontrollohet ndikimi negativ ndaj kualitetit të ajrit të ambientit të objekteve dhe instalimeve për të cilat nuk është paraparë dhënia e lejeve të integruara ekologjike (neni 57) në afat prej më së shumti prej 30 ditëve, afat në të cilin duhet t'i mënjanojnë shkaqet për gjendjen e krijuar.

6) do ta ndalojë punën e personave juridikë dhe fizikë në qoftë se konfirmon se nuk është respektuar procedura për djegien e mbeturinave (neni 56-a), dhe

7) do ta obligojë personin juridik ose fizik i cili nuk i plotëson kushtet për mbrojtjen e ajrit t'i ndërmarrë masat e nevojshme dhe do t'i caktojë afat për plotësimin e të njëjtave.

(2) Në rastin kur do të vërtetohet ekzistimi i rrezikut të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e njerëzve, inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor do të japë urdhër me gojë për mënjanimin urgjent të mangësive të caktuara, të cilat me procesverbal i konstaton në bashkëpunim me Inspektoratin shtetëror sanitar dhe shëndetësor, si dhe do t'i lajmërojë edhe inspektoratet tjera kompetente ose organet tjera shtetërore për parregullsitë e caktuara dhe do të kërkojë intervenimin e tyre.

(3) Në rastet nga paragrafi (2) të këtij neni inspektori merr vendim me shkrim në afat prej 48 orëve nga dita e dhënies së urdhërit me gojë.

(4) Nëse edhe për herë të dytë gjatë vitit është bërë thyerja e njëjtë nga paragrafi (1) pika 5 e këtij neni, inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor do të shqiptojë ndalim për kryerjen e veprimtarisë në afat prej më shumë se 60 ditë, afat në të cilin duhet t'i mënjanojë shkaqet për gjendjen e krijuar.

(5) Për kryerjen e punëve nga paragrafi (1) pika 1 e këtij neni, inspektori për mjedisin jetësor ka të drejtë për ndërmarrjen edhe të masave të tjera të përcaktuara me Ligjin për mjedisin jetësor.

## Neni 69-a

### Procedura e edukimit

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, përkatësisht inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, i cili e ka kryer mbikëqyrjen inspektuese, konstaton se është kryer parregullsi nga neni 75-a, paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji, ka për detyrë që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së konstatuar në afat prej tetë ditësh dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për realizimin e edukimit të personit ose subjektit, ku është konstatuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim, si dhe mënyrën e realizimit të edukimit, e përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Edukimin e organizon dhe realizon Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, përkatësisht inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, në afat jo më të gjatë se tete dite nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese.

(4) Edukimi mund të realizohet për më shumë parregullsitë konstatuara të njëjta ose të ngjashme për një ose më tepër subjekte.

(5) Nëse në terminin e caktuar personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

(6) Nëse personi ose subjekti për të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen atë, do të konsiderohet se është edukuar

lidhur me parregullsinë e konstatuar.

(7) Nëse inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, përkatësisht inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, gjate kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë mënjanuar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi (1) i këtij neni, miraton konkluzion me të cilin e ndërpret procedurën e mbikëqyrjes inspektuese.

(8) Nëse inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, përkatësisht inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se nuk janë mënjanuar parregullsitë e konstatuara nga paragrafi (1) i këtij neni, kryerësit të kundërvajtjes ka për detyrë që t'i propozojë procedurë për barazim para se të parashtrojnë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje.

(9) Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor, përkatësisht inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor mban evidencë unike për edukimin e realizuar në mënyrën e përcaktuar nga ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor.

## **Neni 69-b**

### **Raporte**

Inspektori shtetëror i mjedisit jetësor, përkatësisht inspektori i autorizuar i mjedisit jetësor, ka për detyrë që të mbajë evidencë për mbikëqyrjet dhe inspektimet e kryera të personave juridikë dhe fizikë, për të cilat përpilon raport tremujor dhe e publikon atë në ueb faqen e organit të administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mjedisit jetësor, përkatësisht në ueb faqen e komunës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit.

## **Neni 70**

### **Kompetencat tjera**

(1) Inspektori për mjedisin jetësor dhe inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësor të komunës dhe Qytetit të Shkupit është i obliguar të paraqesë fletëparaqitje penale dhe fletëparaqitje ndëshkuese te gjykatat kompetente për zbatimin e procedurës penale përkatësisht ndëshkuese, nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes vërteton bazë për të njëjtat

(2) Nëse inspektori për mjedisin jetësor dhe inspektori i autorizuar për mjedisin jetësor i komunës dhe i Qytetit të Shkupit nuk i ndërmarrin veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, do të llogaritet se ka bërë thyerje më të rëndë të vendit të punës.

## **Neni 71**

### **Procedura ndaj ankesës**

(1) Ankesë kundër aktvendimit të inspektorit shtetëror të mjedisit jetësor, mund të paraqitet në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(2) Ankesë kundër aktvendimit të inspektorit të autorizuar të mjedisit jetësor, mund të paraqitet në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit në Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë.

(3) Ankesa kundër aktvendimit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.



## Neni 72

### Obligimet e personave fizikë dhe juridikë

Personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar t'u mundësojnë inspektorëve kryerjen e mbikëqyrjes dhe kontrollit në dokumentacion, t'ua japin informatat e kërkuara, sqarimet dhe lajmërimet që janë me interes për kryerjen e drejtë të mbikëqyrjes.

## Neni 73

### Mbikëqyrja e lidhshmërisë së punës së organeve të komunës

(1) Mbikëqyrja ndaj ligjshmërisë së punës së organeve të komunës përkatësisht Qytetit të Shkupit, bazohet në parimin e ligjshmërisë, përgjegjësisë dhe pavarësisë në zbatimin e kompetencave të tyre.

(2) Mbikëqyrjen nga paragrafi (1) të këtij neni e kryen organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor.

(3) Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së punës të organeve të komunës dhe të Qytetit të Shkupit, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor i kryen punët vijuese:

1) përcjell punën e organeve të komunës dhe të Qytetit të Shkupit dhe ndërmerr masa, aktivitete dhe paraqet iniciativë për realizimin e kompetencave të komunës dhe Qytetit të Shkupit sa i përket përgatitjes, miratimit dhe zbatimit të programeve, planeve edhe akteve të tjera;

2) vlerëson se a e kryejnë organet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit përgatitjen, miratimin dhe zbatimin e dokumentet e planit dhe akteve të tjera, si dhe paraqitjen e raporteve për zbatimin e tyre me procedurat e përcaktuara me këtë ligj;

3) i paralajmëron organe të komunës dhe Qytetit të Shkupit për tejkalimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj dhe propozojnë masa përkatëse për tejkalimin e kësaj gjendje;

4) paralajmëron për mangësi të caktuara materiale dhe procedurale në punën e organeve të komunës dhe të Qytetit të Shkupit, me të cilat do të mund ta pengojnë realizimin e të drejtës së publikut për qasje deri te informatat dhe pjesëmarrje në marrjen e vendimeve dhe të drejtave dhe obligimeve të tjera të përcaktuara me këtë ose ligj tjetër;

5) jep rekomandime për zbatimin konsekuent të kompetencave të komunës dhe Qytetit të Shkupit për punë që duhet t'i kryejnë në pajtim me këtë ligj, me kërkesën e organeve të komunës dhe Qytetit të Shkupit;

6) përcjell miratimin me kohë të dokumenteve me plan dhe akteve të tjera nga ana e komunave dhe Qyteti i Shkupit;

7) u paraqet iniciativa dhe propozime organeve të komunës dhe Qytetit të Shkupit nëse konstaton moszbatimin e këtij ligji si rezultat i i konfliktit të kompetencave në mes tyre;

8) përcjell ligjshmërinë e vendimeve që i merr prefekti në zgjidhjen e të drejtave, obligimeve dhe interesave individuale të personave juridikë dhe fizikë në pajtim me këtë ligj;

9) Jep mendim dhe ndihmë profesionale me kërkesën e organeve të komunës dhe të Qytetit të Shkupit për propozim dokumentet e planit dhe aktet të tjera që dalin nga ky ligj.

10) me kohë i lajmëron organet e komunës dhe Qytetit të Shkupit për gjendjen e konstatuar në punën e tyre dhe masat e ndërmarra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes dhe;

11) përcjell realizimin e transparencës në punën e organeve të komunës dhe Qytetit të Shkupit në realizimin e kompetencave të përcaktuara me këtë ligj në aspekt të informimit të rregullt, me kohë, të vërtet dhe të plotë të qytetarëve.

## Neni 74

## Marrja e kryerjes së kompetencave

(1) Nëse edhe përveç paralajmërimeve dhe masave dhe aktiviteteve të ndërmarra, organet e komunës dhe të Qytetit të Shkupit nuk e sigurojnë kryerjen e punëve për të cilat ata janë kompetente në pajtim me këtë ligj, u merret kryerja e punëve nga kompetenca e tyre.

(2) Kryerjen e punëve të marra i ndërmerr organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e mjedisit jetësor më së shumti deri në një vit nga dita e marrjes së tyre, në emër dhe në llogari të komunës dhe të Qytetit të Shkupit.

(3) Për ndërmarrjen e punëve nga paragrafi 1 i këtij neni informohet organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e vetadministrimit lokal dhe organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e financave.

## XII. SANKSIONE PËR KUNDËRVAJTJE

### Neni 75

(1) Gjoha në shumë prej 500 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik në qoftë se:

1) djeg mbeturinë në hapësirë nën qiell të hapur gjegjësisht djegien e mbeturinës nuk e bën në instalimet për atë dedikim (neni 56-a)

(2) Gjoha në shumë prej 300 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik për veprimin nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Gjoha në shumë prej 150 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit fizik për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Organ kompetent për kumtimin e kundërvajtjeve të këtij neni është Komisioni për kundërvajtje i formuar në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(5) Për kundërvajtjet e këtij neni inspektorët kompetentë sanksionin për kundërvajtje mund t'ia kumtojnë aty për aty me dorëzimin e ftesës për pagimin e gjobës të cilën kryerësi është i obliguar ta paguajë në afat prej 8 ditësh.

(6) Në qoftë se gjoba nga paragrafi (5) të këtij neni nuk paguhet në afatin e përcaktuar, inspektorët shtetërorë dhe inspektorët e autorizuar për mjedisin jetësor janë të obliguar të parashetrojnë kërkesë për ngritjen e procedurës para Komisioni për kundërvajtje të formuar në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

### Neni 75-a

(1) Gjobë në shumë prej 1.000 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

1) nuk dorëzon në afatin e përcaktuar në organin kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor, të dhëna të nevojshme për emisionet dhe për burimet e emisioneve (neni 45 paragrafi (2));

2) nuk mundëson qasje në informatat dhe të dhënat për cilësinë e ajrit të mjedisit (neni 51 paragrafi (2)) dhe

3) nuk ia dorëzon të dhënat e përcaktuara dhe të dhënat tjera të nevojshme përpiluesit dhe/ose mbajtësit të Kadastrës (neni 52 paragrafi (5)).

(2) Gjobë në shumë prej 500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 300 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik për veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni.

## Neni 76

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik në qoftë se:

- 1) kryen punë të përcaktuara profesionale për monitorim të kualitetit të ajrit të ambientit, në kundërshtim me kushtet e përcaktuara (neni 42 paragrafi (2));
- 2) nuk instalon dhe nuk i mirëmban në gjendje të rregullt instrumentet matëse për ndjekje të emisioneve në vendin e burimit (neni 45 paragrafi (1) pika 1);
- 3) nuk siguron ndjekje të rregullt, matje dhe përpunimin e të dhënave nga emisionet dhe nuk mban ditar për burimet e emisioneve në mënyrë të përcaktuar (neni 45 paragrafi (1) pika 2));
- 4) nuk ndërton sistem për ndjekjen e burimit të emisioneve dhe për kontroll të kualitetit e ajrit të ambientit në rajonin e objektit (neni 47 paragrafi (1));
- 5) nuk i realizon kushtet me të cilat pengohet, zvogëlohet ose kontrollohet ndikimi negativ ndaj kualitetit të ajrit të ambientit (neni 57);
- 6) nuk e njofton organin kompetent për kryerjen e punëve profesionale nga sfera e mjedisit jetësor, gjegjësisht komunën dhe të Qytetit të Shkupit për burimin e ndotjes, për ndryshimin e lëndëve të para dhe proceset teknologjike, si dhe për punët riparuese të aparateve që priten dhe pajisjeve (neni 60 paragrafi (1) pika 1));
- 7) nuk e njofton organin kompetent për kryerjen e punëve profesionale në sferën e mjedisit jetësor, gjegjësisht komunën dhe Qytetin e Shkupit për ndryshimin e lëndës së veprimtarisë, ndryshimin e operatorit të instalimit dhe personat përgjegjës për ruajtjen e mjedisit jetësor (neni 60 paragrafi (1) pika 2)), dhe
- 8) nuk mundëson qasje të lirë te burimet e ndotjes së ajrit të ambientit dhe te dokumentacioni dhe të dhënat të lidhura me emisionet (neni 60 paragrafi (1) pika 4)).

(2) Gjobë në shumë prej 700 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 500 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit fizik për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Organ kompetent për kumtimin e sanksioneve për kundërvajtjeve të këtij neni është Komisioni për kundërvajtje i formuar në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor

## Neni 77

(1) Gjobë në shumë prej 8.000 euro deri 20.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik në qoftë se:

- 1) zbraz në ajrin e ambientit substanca ndotëse mbi vlerat e përcaktuara kufitare për emision (neni 15 paragrafi (1));
- 2) prodhon, importon dhe lëshon në qarkullim mjete transportuese të cilat nuk i plotësojnë vlerat e përcaktuara kufitare për emision prej burimeve të lëvizshme (neni 15 paragrafi (2));
- 3) prodhon, importon dhe lëshon prodhime të veçanta të cilat nuk i plotëson vlerat e përcaktuara kufitare për përmbajtjen e substancave të dëmshme dhe kërkesat tjera për kualitetin e lëndëve djegëse (neni 16);
- 4) nuk i plotëson obligimet për zbatimin dhe financimin e masave për zvogëlimin e emisioneve të përcaktuara në dokumentet e planit (neni 28);
- 5) e fshirë <sup>5</sup>
- 6) vepron në kundërshtim me urdhëresën për kufizimin ose ndalesën për

kryerjen e veprimtarive të caktuara (neni 59);

7) nuk e njofton inspektoratin kompetent për avaritë në prodhimtari dhe incidente tjera, si dhe nuk ndërmerr masa adekuate në rastet e tilla (neni 60 paragrafi (1) pika 3)), dhe

8) zbraz substanca ndotëse jashtë nga stabilimentet për zbrazje në ajrin e ambientit (neni 61 paragrafi (1)).

(2) Gjobë në shumë prej 1.400 deri 2.500 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit përgjegjës në personin juridik për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1.000 deri 1.500 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit fizik për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Për veprimet nga paragrafi (1), pikat 1), 2), 3), 7) dhe 8) të këtij neni, personit juridik krahas gjobës, mund t'i shqiptohet edhe sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje më së shumti 30 ditë.

(5) Organ kompetent për kumtimin e sanksioneve për kundërvajtjeve të këtij neni është gjykata kompetente.

## **Neni 77-a**

### **Procedura për barazim dhe ndërmjetësim**

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 75 dhe 76 të këtij ligji, inspektorët shtetërorë dhe inspektorët e autorizuarit janë të obliguar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojnë procedurë për barazim, para se të parashtrajnë kërkesë për procedurë për kundërvajtje.

(2) Për kundërvajtjet nga neni 77 i këtij ligji, inspektorët shtetërorë dhe inspektorët e autorizuarit kryerësit të kundërvajtjes mund t'i ofrojnë ndërmjetësim dhe arritjen e pajtimit me të cilin kryerësi i kundërvajtjes duhet që ta paguajë gjobën, ose detyrimet tjera ose t'i evitojë pasojat nga kundërvajtja.

(3) Në rastet në të cilat është arritur pajtimi për ndërmjetësim dhe barazim, gjoba kryerësit mund t'i zvogëlohet më së shumti për gjysmën nga maksimumi i gjobës për kundërvajtjen.

(4) për kundërvajtjet nga neni 77 të këtij ligji inspektorët shtetërorë dhe të autorizuar si dhe kryerësit i kundërvajtjes mund të pajtohen për fillimin e procedurës të ndërmjetësimit para se të parashtrajnë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në pajtim me Ligjin për mjedisin jetësor.

(5) Procedurat për barazim dhe ndërmjetësi udhëhiqen në pajtim me dispozitat nga Ligji për mjedisin jetësor.

## **Neni 77-b**

### **Mbajtja e procedurës për kundërvajtje**

Procedura para organit për kundërvajtje mbahet në pajtim me dispozitat nga Ligji për mjedisin jetësor.

## **XII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 78**

Plani nga neni 25 dhe Dokumentet e planit nga nenin 26 të këtij ligji do të miratohen në afat prej 6 muajve nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

## Neni 79

(1) Dispozitat e posaçme për zbatimin e këtij ligji do të miratohen në afat prej tre vjetësh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

(2) Deri në hyrjen në fuqi të dispozitave nga paragrafi (1) i këtij neni, do të zbatohen dispozitat ekzistuese.

## Neni 80

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, ndërpritet të vlejë ligji për mbrojtjen e ajrit dhe nga ndotja ("Gazeta Zyrtare e RSM" nr. 20/74, 6/81, 10/90 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 50/92, 62/93), përveç dispozitave të nenit 4 paragrafët 1, 2, 3, 4 5 dhe 6 të Ligjit, të cilat do të zbatohen me ditën e hyrjes në fuqi të dispozitave të posaçme për zbatimin e këtij ligji.

## Neni 81

Ky ligj hyn në fuqi ditën e 8 nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet nga dita e konstituimit të këshillave të komunave dhe të Qytetit të Shkupit dhe zgjedhjes së prefektëve të komunave dhe prefektit të Qytetit të Shkupit pas zbatimit të zgjedhjeve të para të ardhshme lokale në pajtim me Ligjin për zgjedhjet lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 46/96, 12/2003, 35/2004, 52/2004 dhe 60/2004).

### **DISPOZITA NGA LIGJE TË TJERË**

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për cilësinë e ajrit të ambientit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/2011):

#### **Neni 10**

Rregullat më të përafërta të përcaktuara me nenin 6 të këtij ligji, do të miratohen në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për cilësinë e ajrit të ambientit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/2011):

#### **Neni 11**

Dispozitat e nenit 7 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për mbikëqyrje inspektuese.

Ligji për ndryshimin e Ligjit për cilësinë e ajrit të ambientit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 163/2013):

#### **Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet nga 1 maji 2014.